



UNIVERSITETI F.S.NOLI, KORÇË

REZULTATET E STUDIMIT

Mbi nevojat dhe mundësitë që ofron
tregu i punës për punësimin e të
diplomuarve nga Universiteti F. S. Noli,
Korçë

RAPORT ANALITIK



UNIVERSITETI I KORÇËS

REKTORATI

Shtator 2022

RAPORT PËRMBLEDHËS

Për studimin e tregut të punës në rajonin juglindor dhe analiza e kapaciteteve të Universitetit “Fan S. Noli” në përmbushje të kërkesave aktuale të kualifikimeve”

Përgatitur nga Grupi i punës:

Dr. Emil Frashëri
Prof.as.dr Eleni Vangjeli
Doc./Dr. Marinela Teneqexhi
Romeo Terolli

dhe

Instituti për Cilësi në Arsim
Adresa: Rr.Panajot Pano, Nr. 1051, Tiranë Shqipëri
Web: www.iqe.al
Email: info@iqe.al
Tel: 0682264725

Ky raport paraqet në mënyrë të përmbledhur rezultatet e studimit të tregut të punës në rajonin juglindor dhe analizon kapacitetet e Universitetit “Fan S. Noli” në përmbushje të kërkesave aktuale të kualifikimeve. Ai është kryer nga Grupi i punës dhe Instituti për Cilësi në Arsim, të zhvilluar gjatë periudhës Prill - Shtator, 2022.

Grupi i punës falenderon drejtuesit e institucionit për besimin e dhënë dhe njëkohësisht deklarojmë me përgjegjësi se në vijim kemi paraqitur rezultatet, gjetjet dhe konstatimet sikundër ato janë identifikuar gjatë studimit.

Ne shpresojmë që informacioni i paraqitur në këtë raport t'i shërbejë institucionit, që ai të fokusohet në përmirësimin e rolit të vet në tregun e punës në rajonin juglindor dhe njëkohësisht të rrisë impaktin e tij në rajon e më gjerë

Ju faleminderit!
Shtator 2022



Përmbajtja:	
HYRJE	4
I. QARKU I KORÇËS DHE PESHA E TIJ NË EKONOMINË DHE ZHVILLIMIN E VENDIT	6
1. Qarku i Korçës, informacione dhe statistika	6
2. Ekonomia rajonale, drejtimet kyesore të zhvillimit	8
3. Tregu rajonal i punësimit dhe mundësitë	12
II. UNIVERSITETI F.S.NOLI, KORÇË, KONTRIBUTET E TIJ NË ZHVILLIMIN SOCIAL-EKONOMIK E KULTUROR TË RAJONIT DHE VENDIT	15
1. Universiteti i Korçës, F.S.Noli, informacione dhe statistika	15
2. Programet e studimit, profili dhe përmbajtja e tyre	17
3. Studentët dhe diplomuarit, aksesit i tyre në tregun e punës	19
III. ORIENTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË UK DREJT TREGUT TË PUNËS DHE PUNËSIMIT	21
1. Metodologjia e studimit	21
2. Mendimi i studentëve të diplomuar për UK dhe tregut të punës për programet e studimit dhe orientimin e tyre	25
3. Vlerësime dhe rekomandime të ekspertëve të jashtëm për UK dhe programet	31
IV. ANALIZA E TREGUESËVE KRYESORË PËR ORIENTIMIN E PROGRAMEVE DREJT TREGUT TË PUNËS, GJETJE DHE REKOMANDIME	34
1. Statusi aktual i programeve të UK dhe përputhshmëria me strategjitë rajonale e kombëtare të zhvillimit	34
2. Kapacitetet dhe mundësitë reale të punësimit në rajonin juglindor dhe reflektimi i kërkesave të tregut të punës	38
3. Mbështetja e studentëve për punësim, karrierë të suksesshme dhe promovimi i praktikave të mira	41
4. Roli i UK si nyje lidhëse midis tregut të punës, studentëve dhe të diplomuarve të vet	44
5. Përspektiva e programeve e reja të studimit për përmbushjen e kërkesave të tregut të punës në qarkun e Korçës e më gjerë	46
V. KONKLUZIONE DHE PËRFUNDIME	49

HYRJE

Universiteti “Fan S. Noli” (UK) është një nga institucionet publike të një rëndësie të veçantë për rajonin juglindor të vendit por edhe për arsimin e lartë në tërësi. Me histori dhe kontribut domethënës në fushën e arsimit të lartë e kërkimit shkencor, institucioni përballet me sfida të reja që lidhen me faktorë jashtë institucionit si p.sh kërkesat e reja të tregut të punës, ndryshimi i ndjeshëm i profileve të listës së profesioneve, lëvizjet demografike, ulja e vazhdueshme e numrit të maturantëve në rajonin juglindor, nevoja për implementimin e teknologjive të reja që reduktojnë kostot e biznesit dhe rrisin efikasitetin, etj.

Përballja me këto sfida, ka bërë që institucioni prej kohësh të ndryshojë qasjen e vet në ofrimin e edukimit cilësor në përmbushje të kërkesave të tregut të punës dhe njëkohësisht të rrisë rolin e tij rajonal e kombëtar si kontribues i drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social-kulturor e shkencor të vendit.

Pas kryerjes së disa studimeve në fusha të caktuara si atë të bujqësisë apo ekonomi-biznesit, institucioni në vitet e fundit e ka parë të arsyeshme kryerjen e një studimi gjithpërfshirës në nivel institucional për të gjithë tregun e punës jo vetëm në rajonin juglindor por edhe më gjerë, duke përfshirë dhe rajone të vendeve fqinje si Greqia veriore, Maqedonia e Veriut etj.

Realizimi i këtij studimi të mirëfilltë u mendua të mbështetej në një projekt të veçantë studimor me angazhimin e disa prej ekspertëve më të mirë brenda institucionit, por dhe me ekspertë të jashtëm.

Me vendim të Bordit të Administrimit të Univesitetit “Fan S. Noli”, nr.143, dt. 16.03.2022, u miratua projekti **“Studim i Tregut të punës në rajonin juglindor dhe analiza e kapaciteteve të Universitetit “Fan S. Noli” në përmbushje të kërkesave aktuale të kualifikimeve”**.

Si objektiv themelor, ky projekt synon kryerjen e një studimi të mirëfilltë shkencor të bazuar në të dhëna që institucioni disponon ndër vite, informacione nga tregu i punës, të mbledhura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet anketimeve të ndryshme, analiza statistikore dhe raporte të publikuara nga njësitë lokale, rajonale apo institucionet qendrore mbi zhvillimin ekonomik, punësimin, edukimin, etj, si dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit.

Rezultatet e këtij studimi përmblihen në një raport analitik mbi studimin e tregut rajonal të punës, sfidat dhe mundësitë në kuadër të zhvillimit afatgjatë të UK. Raporti analitik paraqet gjithashtu një numër të madh të dhënash, statistikash e informacionesh që do t'i shërbejnë institucionit në hartimin e politikave të brendshme afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit. Ndërsa informacioni i përmbledhur, paraqitet në këtë dokument.


Grupi i punës falenderon drejtuesit e institucionit për besimin e dhënë në zhvillimin e këtij studimi dhe njëkohësisht deklarojmë se në kryerjen e këtij studimi, jemi përpjekur të pasqyrojmë me profesionalizëm gjetje dhe konstatime të bazuara në shërbim të zhvillimit të institucionit dhe rajonit juglindor.

I. QARKU I KORÇËS DHE PESHA E TIJ NË EKONOMINË DHE ZHVILLIMIN E VENDIT

1. Qarku i Korçës, informacione dhe statistika

Qarku i Korçës është një nga 12 qarqet e vendit dhe ka një sipërfaqe prej 3.711 km². Qarku i Korçës përfshin bashkitë e Devollit, Kolonjës, Korçës, Maliqit, Pustecit dhe Pogradecit. Qendra e Qarkut të Korçës ndodhet në qytetin e Korçës, i cili njëkohësisht është qyteti më i madh i rajonit juglindor. Qarku i Korçës kufizohet në verilindje dhe në lindje me Maqedoninë e Veriut, në jug me Greqinë, në jugperëndim me qarkun e Gjirokastrës, në perëndim me Qarkun e Beratit dhe në veriperëndim me Qarkun e Elbasanit.

Rajoni i Korçës është një nga qendrat më të mëdha dhe më të zhvilluara të Shqipërisë. Ai shquhet për kontributin e madh në zhvillimin e vendit qysh në lashtësi e deri më sot. Ky kontribut kushtëzohet nga një sërë faktorësh: Pozita Gjeografike, Kushtet Klimaterike, Flora, Fauna Burimet Ujore, Burimet nëntokësore




Qarku i Korçës ka një popullsi prej 197.303 banorësh nga 220.357 banorë që ka qënë në vitin 2011¹. Për shkak të faktorëve të ndryshëm, si lëvizjet demografike, emigrimi, ulja e numrit të lindjeve etj, popullsia e qarkut është ulur me 23000 banorë, prej vitit 2011. Për këto arsye, qarku i Korçës, prej vitesh tashmë ka raport negativ të shtimit të popullsisë (lindjesh dhe të ardhurish brenda qarkut në raport me numrin e vdekjeve të larguarit brenda dhe jashtë vendit)

¹ Censusi i popullsisë dhe i banesave: http://www.instat.gov.al/media/3065/7__korce.pdf

Shqetësues është fakti se vetëm në vitin e fundit, popullsia e qarkut është ulur me rreth 5000 banorë (shih grafikun), duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në numrin e popullsisë aktive.

Sipas një projekcioni të bazuar në këto shifra të INSTAT (me shtesë mesatare natyrore prej – 147 banorësh), rezulton se popullsia e qarkut pas 10 viteve pritet të jetë rreth 170000 banorë, në skenarin më të mirë të mundshëm.

Rënia e popullsisë, veçanërisht asaj të re, përkthehet në mënyrë automatike, në uljen e numrit të nxënësve dhe studentëve kandidatë potencialë për të studiuar në UK.



Në vjetarin statistikor rajonal 2019 dhe 2021², moshë mediane e popullsisë ishte 37 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 6,7% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Shqipëri. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Korçës është 9.1 nxënës për mësues, por ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Pustecit ka raportin më të ulët prej 4.9 nxënës për mësues, ndërsa raportin më të lartë e ka Bashkia e Korçës me 11,4 nxënës për mësues. Përqindjen më të madhe të shkollimit të nxënësve e mbulon sektori publik me rreth 94%. Të diplomuarit në arsimin e mesëm janë kryesisht me gjimnaz me rreth 85%, 11% arsim profesional dhe vetëm 4 % me arsimim social kulturor.

Në raport me qarqet e tjera, qarku i Korçës ka numrin më të ulët të nxënësve që ndjekin arsimin profesional.

² http://www.instat.gov.al/media/9432/vjetari-statistikor-2021_final-29122021.pdf

Përsa i përket zhvillimit ekonomik, qarku i Korçës bën pjesë në rajonet me zhvillim ekonomik mesatar. Për shkak të pozicionit gjeografik, rajoni ka shkallë të lartë emigracioni. Kontribuesi kryesor për shumë familje vazhdon të jetë emigracioni në vendet fqinje ose largimi i profesionistëve drejt vendeve të Bashkimit Evropian.

Në vitet e fundit rezulton se popullsia e qarkut të Korçës është ulur nga viti në vit. Kjo ulje do të vazhdojë edhe për vitet në vijim, për aq kohë sa niveli i lindjeve të jetë në rënie dhe shkalla e migrimit të brendshëm dhe emigracionit të jetë e lartë. Në këtë kontekst, në vitet në vijim, ulja e popullsisë çon në mënyrë të pashmangshme në uljen e numrit të nxënësve në shkolla e mandej të studentëve në arsimin e lartë. Sikundër kemi treguar edhe në Seksionin II.1, ulja e numrit të studentëve në UK apo në nivel kombëtar, mbështet këtë konkluzion.

Në strategjinë e vet të zhvillimit, institucioni duhet të shohë në planin afatgjatë mundësi të reja për minimizimin e impaktit të krijuar për shkak të uljes së numrit të popullsisë. Ne sugjerojmë orientim të institucionit përtej rajonit të Korçës, duke marrë në konsideratë rajonet ndërkufitare dhe nevojat që ato kanë, për të krijuar mundësi për studentët nga vendet fqinje e përtej tyre. Nga ana tjetër, institucioni duhet të bëjë të njohur problematikën e krijuar lidhur me rënien e numrin e studnetëve në organet politikëbërëse, qeverinë shqiptare për të marrë në konsideratë politika mbështetëse ndaj Universitetit të Korçës duke e konsideruar atë aset in më të rëndësishëm dhe që duhet të jetë pjesë integrale e zhvillimit të rajonit

2. Ekonomia rajonale, drejtimet kyesore të zhvillimit

Në vitet e fundit ekonomia shqiptare ka qënë nën ndikimin e disa faktorëve të jashtëm. Pandemia Covid-19 dhe masat shtrënguese të ndërmarra nga autoritetet tkurrën mjaft aktivitetin ekonomik të vendit. Shqipëria është veçanërisht e ekspozuar ndaj tkurrjes ekonomike prej pandemisë për shkak se mbështetet fort nga sektori i turizmit dhe për shkak të marrëdhënive të saj intensive me disa ekonomi të BE-së të prekura nga pandemia. Parashikohet që rënia ekonomike e vitit 2022 të jetë rreth 4.4 për qind.

Ndikim përveç pandemisë, gjatë vitit 2021-2022, ka patur lufta në Ukrainë, kriza e çmimeve për disa mallra e produkte që sigurohen nga importi. Këto faktorë kanë bërë që ekonomia shqiptare të pësojë tkurrje, inflacion dhe reçesion.

Këto ndikime janë vërejtur në pothuaj të gjithë sektorët e ekonomisë, veçanërisht në atë energjistik, tek lëndët djegëse, lëndët e para për prodhim që sigurohen nga importi etj. Ende nuk ka një studim gjithëpërfshirës përse i përket impaktit në ekonominë shqiptare të pandemisë dhe krizës aktuale që po kalon bota, ndaj dhe në studimin tonë ne nuk kemi marrë në konsideratë ndikimin e saj në tërësi apo në sektorë të veçantë të saj.

Ne jemi bazuar kryesisht në informacione dhe të dhëna të siguruara nga INSTAT, vjetarë të publikuar, studime dhe raportime të ndryshme të bëra nga institucionet publike. Në vijim, ekonomia e qarkut të Korçës, është analizuar bazuar në të dhënat e siguruara nga burimet e mësipërme. Mirëpresim çdo koment apo sugjerim që çon në saktësimin e tyre.

Qarku i Korçës, kontribuon me rreth 5,6 % në strukturën e PBB-së në Shqipëri, e cila në terma realë përkthehet me minus 0,13 % . Prodhimi i brendshëm bruto, PBB për frymë është rreth 403 mijë lekë, i cili është më i ulët se mesatarja në nivel vendi.

Bazuar në shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas madhësisë së familjes dhe qarqeve, niveli i jetesës në qarkun e Korçës konsiderohet mesatar. Referuar të ardhurave kryesore të siguruar nga aktiviteti ekonomik në rajonin juglindor, sektori i buqësi & blegtori zë vendin kryesor në qarkun e Korçës, i ndjekur nga shërbimet, industria etj. Nga statistikat e INSTAT, pas qarkut të Fierit dhe Elbasanit, qarku i Korçës ka sipërfaqen më të madhe të mbjellë të tokës, me rreth 47000 ha.

Në sektorin e bujqësisë, peshën kryesore e zë pentaria dhe prodhimet blegtorale. Qarku i Korçës është prodhuesi kryesor i frutave në shkallë vendi me rreth 82.000 ton. Duke mos marrë në konsideratë 2 vitet e fundit të pandemisë Covid 19, qarku i Korçës rezulton të jetë qarku më i vizituar nga turistët vendas pas Tiranës. Kjo përkthehet në rritje progresive të kontributit që jep sektori i turizmit në prodhimin e përgjithshëm bruto të qarkut.

Edhe pse burimet nëntokësore të rajonit janë nga më të rëndësishmet në Shqipëri, shfrytëzimi i tyre është pothuaj në nivelin minimal. Potenciali është i jashtëzakonshëm për shfrytëzimin e tyre, çka do të nxiste zhvillimin ekonomik të rajonit.

Përse i përket tregëtisë, rajoni kryen një volum të lartë shkëmbimesh tregëtare, duke dhënë kontribut domethënës, për shkak të pozitës gjeografike që ai ka. Pikat ndërkufitare me Greqinë dhe Maqedoninë

e Veriut mundësojnë akses të shpejtë në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.

Industria është në nivel mesatar, përse i përket kontributit që jep në zhvillimin e rajonit. Sektorët më prioritarë të zhvillimit të industrisë janë industria e konfeksioneve, që përbën rreth 31% të ekonomisë rajonale. Në këtë sektor bën pjesë numri më i madh i ndërmarrjeve me numrin më të madh të të punësuarve në industri.

Pjesa më madhe këtyre ndërmarrjeve janë shoqëri të përbashkëta me kapital të huaj. Produktet kryesisht eksportohen për tregun e huaj. Ky sektor ka mundësi të mëdha zhvillimi, duke marrë në konsideratë ndryshimet në tregjet globale, aksesin e shpejtë në tregjet e huaja, si dhe krahun e punës relativisht i ulët.

Në vijim po japim disa statistika që lidhen me ekonominë rajonale, të cilat në mënyrë të indirekte shprehin potencialin aktual të punësimit që ka rajoni juglindor. Për referencë, jemi bazuar në statistikat e INSTAT të dhëna për vitin 2018 – 2019, duke e konsideruar si vitin me ecurinë më normale përse i përket ecurisë ekonomike dhe ndikimit të faktorëve të jashtëm si pandemia Covid 19, kriza globale etj.

Në vitin 2018, numri në total i ndërmarrjeve në qarkun e Korçës ka qenë rreth 14.000 duke u renditur pas Tiranës dhe Fierit. Sipas kategorive, rreth 7,330 janë regjistruar fermerë, 5,652 të regjistruar persona fizikë dhe 1,053 persona juridikë.

Kryesisht mbizotëron biznesi i vogël familjar, pasi në tipologjinë e tyre, sipas INSTAT, 13,261 janë ndërmarrje që kanë të punësuar 1 - 4 persona, 369 biznese kanë punësuar 5 - 9 persona, 323 biznese kanë të punësuar 10 - 49 persona dhe vetëm 82 ndërmarrje kanë të punësuar mbi 50 persona.

Në qarkun e Korçës, vetëm 127 biznese janë të huaja dhe 13,908 janë me pronësi shqiptare. Pavarësisht pasaktësisë që mund të mbartin këto të dhëna, përse i përket mosdeklarimit të saktë të numrit të punonjësve apo vetëdeklarimeve nga të vetëpunësuarit (profesionet e lira, artizanët e tj), duket qartë që ekonomia e rajonit bazohet kryesisht në biznesin e vogël.

Korça kontribuoi me 5,5 % në strukturën e PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar minus 0,13 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 403 mijë Lekë [për Qarkun Korçë] ishte më e ulët se mesatarja në nivel vendi. Ndërkohë bazuar në shpenzimet

mesatare mujore për konsum sipas madhësisë së familjes dhe qarqeve, niveli i jetesës konsiderohet mesatar.

Referuar të ardhurave kryesore të siguruar nga aktiviteti ekonomik, bujqësia & blegtoria zë vendin kryesor në qarkun e Korçës e ndjekur nga shërbimet. Pas qarkut të Fierit dhe Elbasanit, qarku i Korçës ka sipërfaqen më të madhe të

mbjellë me bimë arash me rreth 47000 ha.

Në sektorin e bujqësisë, peshën kryesore e zë pentaria dhe prodhimet blegtorale.

Qarku i Korçës është prodhuesi kryesor i frutave në shkallë vendi me rreth 82.000 ton.

Treguesit rajonalë të paraqitur në vijim, shprehin se cilat janë degët me peshën më të madhe ndaj totalit të vlerës së shtuar bruto, VSHB, (figura 3). Kontributi më i lartë për vitin është bujqësia, pyjet dhe peshkimi me 21,1% ndaj totalit të VSHB-së, e ndjekur nga dega “tregtia me shumicë, tregtia me pakicë, transporti”, me 18,8% ndaj totalit të VSHB-së.

Kontributin më të ulët për vitin 2018 e jep aktiviteti financiar dhe sigurimet me 2,6% ndaj totalit të VSHB, e ndjekur nga dega “artet, argëtimi dhe relaksacioni” me 3,1% ndaj totalit të VSHB.

Sikundër shihet, kontribuesit kryesorë në ekonominë rajonale, janë bujqësia-blegtoria-peshkimi, tregtia-transporti-turizmi dhe aktiviteti i administratës publike-shëndetësisë-arsimit. Pas këtyre vijnë industria nxjerrëse, përpunuese, ndërtimi tregu imobilar etj.

Ekonomia e qarkut të Korçës, është bazuar kryesisht në veprimtarinë e ndërmarrjeve, bizneseve të vogla/familjare. Natyra e biznesit është kryesisht prodhimi i produkteve bujqësore/blegtorale, shërbimet, tregtia dhe më pak industria. Në rajon mungojnë bizneset e mëdha, korporatat, industria prodhuese etj.

Sektorë të veçantë si industria nxjerrëse e përpunuese, teknologjia dhe inovacioni, janë pak prezentë. Kjo do të thotë se ekonomia rajonale nuk ka kapacitete të larta punësimi e mbi të gjitha nuk mundëson punësim të punonjësve shumë të kualifikuar. Ajo nuk mundëson aftësim dhe avancim të mëtjshëm të tyre në karrierën profesionale për një numër të madh të punësuarish. Nevojat aktuale të kësaj ekonomie janë kryesisht të orientuara drejt individëve me kualifikim dhe aftësi profesionale në nivelin mesatar, njohuri të cilat mundësohen nga edukimi profesional 2 vjeçar, bachelor dhe master profesional. Megjithatë, UK si institucioni i vetëm në rajon, duhet të marrë në konsideratë edhe kërkesat specifike që ka tregu i punës për

të kualifikuar me njohuri të avancuara, duke ruajtur në këtë mënyrë rolin e vet si faktor i rëndësishëm për edukimin, kualifikimin dhe avancimin në karrierë në rajonin juglindor.

3. Tregu rajonal i punësimit dhe mundësitë

Në paragrafin më sipër, analizuam profilin e ekonomisë rajonale, drejtimet kryesore të zhvillimit, kapacitet dhe peshën e saj në kontekstin kombëtar. Në vijim, po analizojmë peshën reale që ka kjo ekonomi e përkthyer në statistika punësimi.

Fillimisht theksojmë se tregu i punës është dinamik dhe ndryshon në mënyrë të vazhdueshme bazuar në raportin kërkesë-ofertë.

Rol të rëndësishëm luajnë politikat e zhvillimit ekonomik që zbatohen në nivel qendror nga qeveria shqiptare apo në nivel lokal nga njësitë e pushtetit vendor.

Gjithashtu, deklarojmë se të dhënat, raportet e paraqitura, mbartin në vetvete pasaktësinë e raportimit nga institucione të ndryshme apo mospërditësime në kohë reale. Ne i jemi referuar përsëri INSTAT si institucioni me të dhënat më gjithëpërfshirëse përsa i përket informacioneve mbi tregun e punës në rajonin juglindor. Ndërsa informacioni që disponojnë njësitë vendore në qarkun e Korçës si bashkitë, zyrat e punës, etj, është i limituar.

Referuar INSTAT, numri i të punësuarve në Qarkun e Korçës në vitin 2019 përbënte rreth 8,3 % të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri. Norma e papunësisë në këtë vit ka qënë 5,9 %. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës e regjistruar në qarkun e Korçës është rreth 67,6% e popullsisë së qarkut (në shkallë vendi është rreth 59,5%).

Raporti i të punësuarve të moshës 15 vjeç e lart ndaj popullsisë të së njëjtës moshë në qarkun e Korçës është rreth 61 %.

Në nivelin e punësimit, sektori i bujqësisë punëson më shumë, i ndjekur nga shërbimet dhe industria. Në 3 vitet e fundit, niveli i punësimit në qarkun e Korçës, është i njëjtë, me një zbritje të vogël krahasuar me vitin 2019. Shkalla e papunësisë është rreth 10 %. Ajo vazhdon të jetë nën nivelin kombëtar prej 11.7%, por me një përkeqësim krahasuar me vitin 2019. Shkalla e ulët e papunësisë, ndikohet nga mosdeklarimi individual apo nga punësimi sezonal në vendet fqinje.

Në sektorin publik në nivel qarku janë punësuar rreth 10000 persona prej të cilëve rreth 120 janë pjesë e administratës së qarkut, rreth 1.300 janë pjesë e administratës publike dhe 1200 janë pjesë e qeverisjes vendore (bashki, komuna etj).

Në sektorin privat (përfshirë bujqësinë) janë punësuar rreth 15000 ndërsa vetë bujqësia punëson rreth 50.000 persona.

Paga mesatare mujore në vitin 2019 ishte rreth 42.000 lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 ishin 74.319 Lekë për familje.

Në qarkun e Korçës funksionojnë afërsisht 123 shkolla 9 vjeçare me rreth 2010 mësues në të cilat janë regjistruar afërsisht 21525 nxënës në arsimin publik dhe rreth 1.063 nxënës në arsimin privat. Në total në nivel qarku funksionojnë rreth 37 gjimnaze dhe 8 shkolla profesionale me një numër total nxënësish prej 9.851 në institucionet publike dhe 687 mësues, ndërkohë që në institucionet private janë 733 nxënës dhe 53 mësues. Çdo vit në shkollat e mesme dhe profesionale të qarkut diplomohen rreth 2500 maturantë nga të cilët 15 deri 18% regjistrohen në Universitetin e Korçës.

Përsa i përket arsimit të lartë, në qarkun e Korçës, janë aktivë 2 institucione të arsimit të lartë, 1 universitet publik me rreth 3000 studentë dhe një shkollë e lartë private me rreth 60 studentë. Personeli akademik, ndihmës-akademik e administrativ i punësuar në këto institucione është rreth 300 individë.

Spektori i shëndetësisë është i përbërë nga 1 spital rajonal, spitale bashkiake, poliklinikat dhe qendrat shëndetësore në komuna e fshatra. Pjesë e sistemit shëndetësor janë spitalet dhe klinikat private, laboratorët mjekësorë, klinikat dentare, farmacitë etj. Në total, sektori shëndetësor publik në qarkun e Korçës ka rreth 40 qendra shëndetësore, 4 spitale rajonale/bashkiake, me një numër total personeli spitalor prej rreth 800 mjekësh dhe infermierësh. Ndërsa sektori privat përbëhet nga rreth 120 njësi të shërbimit shëndetësor me rreth 300 profesionistë të punësuar.

Në studimin tonë, ne kemi vlerësuar se cila është pesha reale që ka UK në plotësimin e nevojave që ky treg ka. Konkretisht, në pyetësin drejtuar partnerëve dhe bashkëpunorëve të UK (rreth 35 institucione, kompani&biznese), ne i pyetëm ata "Gjatë 5 viteve të fundit, në institucionin ku bëni pjesë, sa ka qenë numri i studentëve të diplomuar nga Universiteti i Korçës që keni punësuar?" (seksioni 4).

Universiteti jep kontribut të madh në punësimin e të rinjve në rajon dhe ai duhet të ruajë pozicionin e vet në përmbushjen e nevojave / kërkesave që ka ky sektor. Rritja e cilësisë së studentëve të diplomuar mund të rrisë shkallën e punësimit në raport me të diplomuarit nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend ose jashtë.

E përkthyer në të dhëna, pesha që zë UK në tregun e punës (studentët e diplomuar) është nxjerrë në mënyrë indirekte nga pyetëtori i partnerëve dhe bashkëpunorëve të UK.

Referuar përgjigjeve të dhëna, rezulton se studentët e diplomuar në UK përbëjnë 30 % të punonjësve në institucionet/bizneset me 11-50 të punësuar, 20 % të punonjësve në institucionet/bizneset me 6 - 10 të punësuar, 50 % të punonjësve në institucionet/bizneset me 1 - 5 të punësuar.

Ndërsa në kompanitë me 100 punonjës nuk ka të punësuar që është diplomuar nga UK. Këto të dhëna tregojnë se UK mbulon mbi 35 % të nevojave që rajoni ka patur ose ka.

Ky realisht është një rezultat pozitiv për institucionin dhe pozicionin që ai ka në plotësimin e nevojave të tregut të punës në qarkun e Korçës.

II. UNIVERSITETI F.S.NOLI, KORÇË, KONTRIBUTET E TIJ NË ZHVILLIMIN SOCIAL-EKONOMIK E KULTUROR TË RAJONIT DHE VENDIT

1. Universiteti i Korçës, F.S.Noli, informacione dhe statistika

Në Republikën e Shqipërisë, janë aktive dhe operojnë 42 institucione të arsimit të lartë nga të cilat 15 publike dhe 27 private ku siç duket, numrin më të madh e zënë IAL të kategorisë universitet dhe kolegji universitar.

Në total, numri i programeve të studimit në të gjitha institucionet dhe në të tre ciklet e studimit është rreth 1350 programe.

Numri i studentëve që studiojnë në këto programe është rreth 123.800 duke shënuar rënie në 5 vitet e fundit.

Në raport me institucionet e tjera të arsimit të lartë, UK ka ofruar **56** programe studimi në vitin akademik 2021-2022 të cilat përbejnë rreth **4%** të numrit total të programeve të studimit ndërsa studentët që studiojnë në këto programe janë rreth 3000 dhe përbëjnë **2.4 %** të numrit total të studentëve në arsimin e lartë.

Universiteti F.S.Noli, Korçë, është institucioni i vetëm publik në rajonin juglindor të vendit. Ai ka një histori të gjatë prej themelimit të tij nga viti 1971. Fillimisht u krijua Instituti i Lartë Bujqësor i Korçës (1971-1992), me tre fakultete: i Bujqësisë, i Mësuesisë dhe i Ekonomikut.

Në vitin 1992 ky institucion ka marrë emrin Universiteti Politeknik i Korçës dhe në vitin 1994 iu dha emri "Fan S. Noli" dhe po në këtë vit pranë tij, u çel edhe Shkolla e lartë e Infermierisë. Institucioni është akredituar³ me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 65, datë



³ VBA Nr. 65, datë 21.09.2017, "Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë "Universiteti Fan S. Noli, Korçë"

21.09.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 30.09.2022.

Aktualisht UK përbëhet nga katër fakultete, përkatësisht

1. Fakulteti i Bujqësisë,
2. Fakulteti i Ekonomisë,
3. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe
4. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane.

Fakultetet janë të organizuara në 15 departamente. Në universitet funksionon “Qendra për formimin e vazhduar”, si njësi bazë kërkimore, trajnuese dhe strukturë e formimit të vazhduar, misioni i të cilës është trajnimi i mësuesve në detyrë.

Njësi e Fakultetit të Bujqësisë është edhe Ekonomia didaktike eksperimentale (më tej, EDE) e cila ofron infrastrukturë për kërkim shkencor dhe praktikën profesionale të programeve të studimit të këtij fakulteti.

Studimet në UK janë organizuar në cikle, duke përmbushur kështu kriteret e parashtruara në Deklaratën e Bolonjës.

UK ofron 7 programe studimi të karakterit profesional 2-vjeçar (120 kredite), 25 programe të ciklit të parë (180 kredite), 21 programe master profesional (13 programe të ciklit të dytë master profesional (60 kredite), 8 programe të ciklit të dytë master profesional (120 kredite), 3 programe Master i Shkencave (120 kredite) dhe 1 program të ciklit të tretë / PhD .

Universiteti ka 154 pedagogë me kohë të plotë, 51 personel ndihmës-akademik me karakter administrativ, 11 personel ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe 27 punonjës shërbimi.

Struktura administrative e institucionit përbëhet nga rreth 28 njësi/zyra administrative në varësi të Bordit të administrimit, Rektoratit dhe Fakulteteve.

Numri i studentëve aktivë për vitin akademik 2021-2022, ka qënë 2930 studentë në 2 ciklet e studimit.

Institucioni ka kapacitetet e duhura akademike dhe është duke u përmirësuar vit pas viti. P.sh në vitin akademik 2016 -2017, numri i stafit akademik në total ka qënë:157 pedagoge : 4 prof.dr., 33 Prof.as.dr., 66 Dr.Ph.d. Doc, 47 Msc dhe 7 as/ped/MP ndërsa sot rezultojnë 235 anëtare të personelit akademik nga të cilët 154 personel akademik me kohë të plotë (6 prof.dr., 27 Prof.as.dr., 85 Dr.Ph.d. Doc, 36 Msc), 51 personel ndihmës-akademik me karakter

administrativ, 11 personel ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe 27 punonjës shërbimi. 75% e stafit akademik është i kualifikuar me tituj akademikë dhe grada shkencore, 38 % prej tyre janë duke përfunduar studimet e tyre të doktoratës.

Përsa i përket infrastrukturës dhe logjistikës, universiteti ka bërë dukshëm përmirësime, në vitet e fundit.

Përmirësime ka në sistemet e teknologjisë së informacionit, aksesit në internet, sistemet e edukimit në distancë etj⁴. Institucioni rezulton të jetë aktiv në rajonin juglindor dhe në atë kombëtar përsa i përket aktiviteteve që zhvillon . Stafi i UK. ka angazhim në jetën ekonomike, vendimmarrëse të rajonit, përfaqësohet në grupe pune, projekte e studime që zhvillon pushteti vendor e qendror në rajon.

Në qarkun e Korçës të diplomuarit nga UK përbëjnë rreth 30 % të të punësuarve sipas deklarimeve të bizneseve të përfshira në studimin e kryer.

Ai ka bashkëpunim dhe partneritet të hapur me 50 institucione arsimore, me 116 institucione jo-arsimore, qeveritare dhe joqeveritare. Nga të gjitha marrëveshjet aktive, 77 janë në nivel rajonal, 47 në nivel kombëtar dhe 45 në nivel ndërkombëtar.

Në nivel ndërkombëtar, reputacioni i universitetit përcaktohet nga niveli i bashkëpunimit/mobilitete, kërkimeve, projekteve, artikujve shkencorë të botuar. UK rezulton të ketë një profil dhe ndikim të lartë në rajonin juglindor, mesatar në nivel kombëtar dhe më të ulët në nivel ndërkombëtar.

2. Programet e studimit, profili dhe përmbajtja e tyre

Programet e studimit në Universitetin e Korçës, janë fokusuar në 8 fusha studimit që klasifikohen në nivelet 6 (Bachelor), 7 (Master) dhe 8 (Doktoratë) të kualifikimeve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). UK ofron kurse trajnimi, kualifikimet që lidhen me programet 2-vjeçare profesionale të nivelit 5, (në fund të të cilave ofrohet Diplomë /Certifikatë profesionale).

Programet janë të organizuara në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga 58 programe, 9 (16%) janë akredituar plotësisht, 13 (22%) në pritje të vendimit të BA, 36 (62%) ende nuk kanë nisur procesin e akreditimit. Tek grupi i fundit futen kryesisht programet e ciklit të dytë të mësuësishë për të cilat po pritet unifikimi i programeve nga MAS.

⁴ <http://www.unkorce.edu.al/>

Në fokusin e institucionit, janë edhe kualifikimet e profesionistëve të ardhshëm dhe menaxherëve të rinj teknikë si dhe edukimi në vazhdim i tyre.

UK disponon Qendrën për Formimin e Vazhduar (QFV), spektri i trajnimeve të së cilës përfshin si kualifikimin e mësuesve në detyrë dhe të drejtuesve të arsimit parauniversitar, ashtu edhe krijimin e hapësirave të nevojshme për arsimin gjithëpërfshirës.

Institucioni është duke u fokusuar në shtimin e moduleve që kanë të bëjnë me konceptet e sipërmarrjes, formimit të vazhduar në drejtimet e bujqësisë dhe shëndetit, drejtime në të cilat sikundër analizuar më sipër duhet të ketë interes të veçantë për edukimin në vazhdim.

Bazuar në informacionet e mbledhura në institucion, universiteti planifikon të aplikojë një program të përbashkët të ciklit të tretë “Studime gjuhësore dhe etno-kulturore në rajonin e Ballkanit”, në bashkëpunim me South-West University “Neofrid Rilski”, Blagoevgrad, Bullgari. Një master në “Menaxhimin e Agroturizmit të Qëndrueshëm” planifikohet gjithashtu në koordinim me Universitetin Bujqësor të Plovdivit në Bullgari.

Në përcaktimin e kuotave në çdo program studimi, institucioni merr parasysh kapacitetet pritesë dhe përmbushjen e standarteve të cilësisë, si: infrastrukturën e logjistikën që ai disponon, personelin akademik etj. Referuar të dhënave që UK disponon, rezulton se nga viti në vit ka rënie të numrit të kërkesave të maturantëve që aplikojnë në programet e studimit të UK. Numri total i studentëve të regjistruar në çdo fakultet në vitin akademik 2021-2022, jepet në vijim.

Në raport me kuotat e kërkuara, MAS në 3 vitet e fundit ka miratuar të gjitha kuotat që institucioni ka kërkuar. Për këtë vit akademik, (2022-2023) nuk u miratuan kuotat e programeve Bsc.. Gjuhë dhe kulturë Frenge, Bsc. Biznes dhe tregëti dhe MP Mësues në shkollat profesionale për shkak se nuk kanë pasur regjistrime në dy vitet e fundit. Ndërkohë numri i studentëve të regjistruar është më i ulët se kuotat e miratuara.

Referuar të dhënave nga raundi i parë i regjistrimeve për vitin akademik 2022-2023 si dhe regjistrimet e 3 viteve të fundit në UK, rezulton se programet e UK nuk janë preferencë e parë e maturantëve të qarkut të Korçës. Vetëm regjistrimet në programet Bsc. Infermieri, Financë-Kontabilitet, Edukim fizik dhe sporte kanë ecuri normale.

Ne në vijim, (Seksioni 4) ne analizojmë profilin e këtyre programeve në kontekstin e kërkesave të tregut të punës të rajonit juglindor e në

nivel kombëtar dhe profilin e tyre, për të kuptuar arsyet se pse rezulton një interes i ulët për programet e UK.

3. Studentët dhe diplomuarit, aksesit i tyre në tregun e punës

Një nga asetet më të rëndësishme të institucionit, janë studentët. Pavarësisht përmirësimeve infrastrukturore të bëra ndër vite, numri i studentëve në UK rezulton të jetë në rënie. Në analizën më sipër treguam se nga viti në vit numri i studentëve është ulur më mënyrë të vazhdueshme ku numri i studentëve në 5 vitet e fundit është reduktuar me 39 %.

Kjo rënie është pothuaj në të njëjtat nivele në të 4 fakultetet e UK, nëse analizojmë numrin e studentëve në 4 vitet e fundit.

Kuota Bachelor 1330- regjistrime 535; Kuota Master 974 dhe regjistrime 382, (total + master 2304 kuota- 917 të regjistruar)

Në raporte të ndryshme, rënia vërehet në të gjitha fakultetet e UK.

Nëse analizojmë regjistrimet për çdo program studimi rezulton se në 3 vitet e fundit (të dhëna që institucioni disponon), programet e studimit Infermieri e përgjithshme, mami, Edukim fizik dhe sporte, MP Mësues për arsimin fillor, plotësojnë 100% të kuotave.

Për të parë se në cilat programe ka interes më të madh nga maturantët, kemi analizuar aplikimet dhe regjistrimet në cikle të ndryshme. Referuar të dhënave, rezulton se programet profesionale 2-vjeçare, janë më të kërkuara në raport me ato bachelor dhe master. Ndërkohë, cilësia e studentëve në hyrje referuar mesatares së shkollës së mesme, është relativisht e ulët. Ky nivel studentësh rezulton në të njëjtat vlera në tre vitet e fundit për të gjitha fakultetet me një përmirësim të lehtë në aplikantët e Fakultetit të Bujqësisë.

Përmirësim i vogël vërehet në mesataren e studentëve të diplomuar krahasuar me notën mesatare në hyrje.

Përsa i përket diplomimeve të studentëve, rezulton se rënia është në funksion të regjistrimeve. Në 3 vitet akademike, UK ka diplomuar në total 3378 studentë. Në vitin akademik 2021-2022 u diplomuan 775 studente në të dy ciklet e studimit.

Institucioni prej vitesh ka krijuar një databazë me studentët e diplomuar e cila pasurohet vit pas vitit. Për të analizuar situatën aktuale të punësimit të studentëve të diplomuar, ne ndërtuam një anketë me disa pyetje informuese, në funksion të qëllimit të këtij studimi (analiza e detajuar në seksionin 3).


Për shpërndarjen e pyetësorit, përdorëm një databazë prej 4400 studentësh të vënë në dispozicion nga ana e institucionit.

Pavarësisht pjesëmarrjes së ulët në plotësimin e pyetësorit, disa informacione të rëndësishme rreth studentëve të diplomuar, statusit të tyre të punësimit, u mbledhën dhe u analizuan me anën e tij.

P.sh. prej pyetjes rreth banimit të studentëve, rezulton se në përqindje shumë të lartë, studentët e UK vijnë kryesisht nga Qarku i Korçës, qytetet Korçë, Pogradec Maliq

Ndërkohë pyetjes se ku janë punësuar aktualisht, rezulton se 33 %, janë punësuar pranë vendbanimit të tyre ndërsa pjesa tjetër, jo.

Studentët mendojnë se programet që kanë përfunduar i përgatisin ata për tregun e punës, pasi rreth 45% e studentëve që kanë marrë pjesë në pyetësor, mendojnë se programi reflekton kërkesat që tregu ka.



Nga ana tjetër, edhe pse studentët mendojnë se përgatiten për tregun e punës, statusi aktual i punësimit të tyre tregon se në përqindje të lartë, të diplomuarit janë duke kërkuar një punë, ose punojnë jashtë profilit të tyre. Vetëm 22% e studentëve të diplomuar që kanë marrë pjesë në anketë, punojnë në profilin e tyre të studimeve në institucion publik ose privat.

III. ORIENTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË UK DREJT TREGUT TË PUNËS DHE PUNËSIMIT

1. Metodologjia e studimit

Analiza e tregut të punës, është komplekse pasi në studim duhet të përfshihen të gjithë kontribuesit dhe faktorët që ndikojnë në sjelljen e tij e mandej të studiohen se kush janë aktorët që lidhen drejtpërdrejtë me të, përsa i përket kontribuesëve në plotësimin e nevojave të tij.

Grupi i punës ka marrë në konsideratë një numër të madh të dhënash që integrojnë institucionin me tregun e punës në rajonin juglindor e më gjerë. Në kryerjen me profesionalizëm të këtij studimi, grupi i punës ndërtoi metodologjinë mbi të cilën do të zhvillohej hap pas hapi studimi.

Aktiviteti i parë ka qenë përcaktimi i vizionit dhe qëllimeve të studimit, për të vazhduar më tej me përcaktimin e objektivave dhe mekanizmave për arritjen e këtyre objektivave.

Disa nga objektivat kryesore të parashikuar kanë qenë:

- Analiza e situatës ekonomike, arsimore, sociale-kulturore të Qarkut të Korçës, bashkive dhe komunave në përbërje të tij, nëpërmjet statistikave përmbledhëse për institucionet arsimore publike e jopublike, institucionet shtetërore, njësitë vendore, numrin e bizneseve vendase dhe të huaja, perspektiva të zhvillimit rajonal, në raport me strategjinë kombëtare dhe atë të integritimit evropian, statistika të punësimit dhe ecuria në vitet e fundit.
- Vlerësimi i situatës aktuale të Universiteti të Korçës në rajonin juglindor dhe në nivel kombëtar, ecuria në vite e tij, qëndrueshmëria e programeve në raport me kërkesat e studentëve, numrin dhe nivelin e studentëve në hyrje etj.
- Analiza e kapaciteteve pritëse të UK në raport me programet aktuale dhe mundësitë për hapjen e programeve të reja; analiza e infrastrukturës fizike, logjistika që institucioni disponon, personeli akademik dhe kontributi akademik e kërkimor i tij, evidentimi i fushave/drejtimeve ku institucioni ka kapacitete të mjaftueshme e të qëndrueshme me mundësi zhvillimi, evidentimi i drejtimeve ku personeli akademik është i limituar në numër, grada e tituj shkencorë dhe mundësitë për përmirësim.
- Studimi i nivelit të punësimit të studentëve të diplomuar nga UK, statistika të viteve të fundit, të diplomimit në raport me punësimin

etj, drejtimet me interes dhe problematika të punësimit, ndikimi i emigracionit apo largimet demografike të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

- Analiza e përputhshmërisë së programeve me nevojat dhe kërkesat që kanë patur bizneset, nisur nga vështirësitë që kanë hasur studentët e punësuar.
- Analizë e detajuar për fushat kryesore që UK ofron dhe propozime për riorganizim/ndryshim/përditësim të kurikulave të ofruara, përmirësimi i ofertës akademike në raport me kërkesat e maturantëve
- Vlerësimi i mundësive të zhvillimit të rajonit juglindor, bazuar në politikat rajonale e kombëtare të zhvillimit, strategjitë e zhvillimit, orientimin e tregut dhe biznesit, kërkesat dhe ofertat e punësimit nga industria, bujqësia e mjedisi, teknologjia, inovacioni, shërbimet, arsimi, shëndetësia, etj.

Plotësimi i këtyre objektivave kërkon kryerjen e një analize të mirëfilltë shkencore të bazuar në të dhëna që institucioni disponon ndër vite, informacione nga tregu i punës të mbledhura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet anketimeve të ndryshme, analiza statistikore dhe raporte të publikuara nga njësitë lokale, rajonale apo institucionet qendrore mbi zhvillimin ekonomik, punësimin, edukimin, etj si dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit.

Në përmbushje të rekomandimeve të dhëna nga ekspertët e vlerësimit të programeve të UK në kuadër të akreditimit, UK duhet të kryejë një studim gjithëpërfshirës të kapaciteteve që ka tregu i punës në rajonin juglindor e më gjerë, të trendeve të evoluimit në të ardhmen dhe masave që duhen ndërmarrë në përmbushje të tyre për të patur një panoramë të qartë për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë të statusit ekonomik-social e kulturor të rajonit; në mënyrë që universiteti të orientojë qëndrueshëm veprimtaritë e veta në të ardhmen.

Studimi përmbillet me një raport analitik dhe përmbledhës mbi studimin e tregut rajonal të punës, sfidat dhe mundësitë në kuadër të zhvillimit afatgjatë të UK, si dhe një numër i madh të dhënash e statistikash që do t'i shërbejnë institucionit në hartimin e politikave të brendshme në të ardhmen.

Grupi i punës beson se rezultatet e studimit dhe të dhënat e mbledhura, do të jenë orientuese që institucioni të ndryshojë qasjen e vet në ofrimin e një edukimi cilësor në përmbushje të kërkesave të tregut dhe njëkohësisht të rrisë rolin e tij rajonal e kombëtar si

kontribues i drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social-kulturor e shkencor të vendit. Raporti i hartuar do t'i mundësojë institucionit të ketë një panoramë të qartë lidhur me përmbushjen e kërkesave që tregu ka, të përcaktojë hapa konkretë në strategjinë e vet të zhvillimit, të cilat janë në një linjë me kërkesat që vetë tregu i punës ka.

Në përmbushjen e objektivave të vëna, janë mbajtur 7 takime me grupin e punës e dhe aktorë të tjerë brenda institucionit me strukturat e brendshme të tij, përfaqësues të zyrave të cilat administrojnë informacionin kryesor.

Gjatë kësaj faze është hartuar një plan i detajuar veprimi, i bazuar në afate dhe detyra konkrete.

Grupi i punës dhe njësitë e përfshira në këtë studim, për kryerjen e tij, kanë ndjekur disa metoda për marrjen e rezultateve paraprake dhe përfundimtare të studimit që lidhen me objektivat themelore si:

- A janë programet që ofron universiteti relevante me tregun e punës?
- A përputhen programet e UK me kërkesën e tregut rajonal e më gjerë?
- Sa është në gjendje institucioni t'u dëshmojë studentëve të ardhshëm nëse të diplomuarit në UK kanë karrierë të suksesshme?
- Sa është në gjendje institucioni të shërbejë si nyje lidhëse midis tregut të punës, studentëve apo të diplomuarve?
- Cilat janë kapacitetet reale të punësimit të rajonin juglindor të vendit, industrisë turistike, agropërpunuese, bujqësisë, arsimit, shëndetësisë, administratës, etj, sektorë me zhvillim dhe punësim potencial të rajonit tonë?
- Në çfarë raporti këto kërkesa përmbushen nga të diplomuarit e UK?

Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme, Grupi i punës është bazuar në disa praktika ndërkombëtare për kryerjen e studimeve të ngjashme, të cilat në themel kanë mbledhjen e informacioneve të nevojshme nga disa burime.

Për mbledhjen e informacioneve, GP komunikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë, shpërndau pyetësorë/anketa dhe konsultoi dokumente dhe studime të hartuara nga aktorët dhe institucione për Qarkun e Korçës, strategjitë e zhvillimit, statistika të njësive vendore, drejtorisë dhe zyrave arsimore etj.

Për njohjen me politikat rajonale të zhvillimit, strategjitë në zbatim etj, janë zhvilluar takime në institucionet respektive, ku qëllimi nuk ka

qënë vetëm informimi, por edhe propozimet që mund të vijnë në kuadër të fokusimit të universitetit në këto politika zhvillimi.

Sikundër theksuam, Grupi i punës i ngritur në UK, në bashkëpunim me ekspertë të fushës, ndanë detyrat për mbledhjen e informacioneve të nevojshme. Në fokus të studimit kanë qënë të dhëna që institucioni disponon ndër vite, informacione nga tregu i punës të mbledhura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet anketimeve të ndryshme, analiza statistikore dhe raporte të publikuara nga njësitë lokale, rajonale apo institucionet qendrore mbi zhvillimin ekonomik, punësimin, edukimin, etj si dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit.

Zhvillimi i studimit:

Për shkak të gamës së madhe të informacioneve të nevojshme, Grupi i punës u fokusua fillimisht në vlerësimin dhe analizën aktuale me të cilën funksionon UK. Kjo analizë është e rëndësishme për të kuptuar si institucioni, njësitë kryesore, njësitë bazë dhe strukturat administrative, operojnë gjatë vitit akademik.

Gjatë periudhës Mars-Prill, UK i është nënshtruar procesit të vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit institucional. Pjesë e procesit ka qënë përgatitja e dokumentacionit mbështetës të Raportit të vlerësimit të brendshëm të përgatitur nga ana e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm.

Gjatë këtij procesi janë hartuar dhe përgatitur një numër i madh dokumentesh të cilat Grupi i punës i studioi dhe i analizoi në funksion të përmbushjes së objektivave të studimit.

Në bashkëpunim me Grupin e vlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional dhe Drejtorinë e kurrikulave dhe vlerësimit institucional, pjesë e të cilës është një prej anëtarëve të Grupit të punës, janë vënë në dispozicion një sërë dokumentesh dhe statistikash si:

- Programe studimi të dy cikleve të studimit që UK aktualisht ofron dhe syllabuse të disa lëndëve në përbërje të tyre, aktet rregullatore të institucionit, si Statuti, Rregullorja e institucionit, fakulteteve, të studimeve, programeve etj, statistika studentësh të viteve të fundit për çdo program studimi, aplikime maturanësh, cilësia e maturanëve në aplikim
- Të dhëna për infrastrukturën, logjistikën dhe kapacitetet pritëse që UK ka aktualisht

- Të dhëna për personelin akademik, kategoritë, fushën e studimit të tyre dhe aktivitetin akademik në vitet e fundit, përputhshmërinë e fushës së studimit me profilin e programeve që UK ofron dhe të tjera.

Paralelisht janë zhvilluar takime me përfaqësues të GVB dhe Drejtorisë së Kurrikulave për të analizuar gjetjet e tyre në kuadër të akreditimit institucional. Grupi i punës ka mbledhur informacione nga aktorë të jashtëm dhe partnerë të universitetit si p.sh institucionet e qeverisjes vendore, institucionet arsimore, bizneset private, institucionet shëndetësore, etj.

Është hartuar lista me institucionet që u bënë pjesë e studimit dhe iu kërkua institucionit autorizimi për kontakt të drejtpërdrejtë dhe marrje të informacioneve për llogari të universitetit. Gjithashtu u kërkuan e-maile të studentëve të diplomuar në vite dhe lista e personelit akademik për shpërndarjen e formularëve për marrjen e mendimit dhe feedback. Në raportin analitik jepen të detajuar informacione për zhvillimin e pyetësorëve dhe rezultatet.

2. Mendimi i studentëve të diplomuar për UK dhe tregut të punës për programet e studimit dhe orientimin e tyre

Studentët janë aktori kryesor i një institucioni të arsimit të lartë. Ata janë përfituesit kryesorë të shërbimeve universitare dhe njëkohësisht reflektuesit e drejtpërdrejtë e punës që një institucion bën me studentët e vet.

Studentët dhe të diplomuarit janë pasqyra në të cilën reflektohen të gjitha kontributet e një institucioni në formimin e profesionistëve të rinj. Kënaqshmëria e studentëve apo të diplomuarve dhe përmbushja e pritshmërive të tyre, është synimi kryesor i çdo institucioni.

Në rastin konkret, marrja e mendimit të studentëve të diplomuar, vështirësitë dhe sfidat që ata kanë ndeshur gjatë punësimit të tyre, është mjaft e vlefshme të njihet nga ana e institucionit.

Këto të dhëna tregojnë një këndvështrim tjetër të funksionimit të UK, sa dhe si studentët e diplomuar janë vlerësuar dhe mbështetur gjatë studimeve të tyre.

Në takimet me përfaqësues të institucionit, Grupi i punës, mori informacione që lidhen me statistikën e përgjithshme të studentëve, cilësinë e tyre në hyrje e dalje, databazën e studentëve të diplomuar dhe si ajo përditësohet.

Në përmbushje të objektivit të studimit, për marrjen e mendimit të studentëve të diplomuar, u kërkuan e-mailet e studentëve të diplomuar në 5 vitet e fundit.

Në dispozicion të grupit të punës u vunë 4458 e-maile të studentëve të diplomuar nga viti 2016.

Pyetëtori i titulluar *“Mendimi i studentëve të diplomuar: Studimi i tregut të punës në rajonin juglindor dhe analiza e kapaciteteve të universitetit “Fan S. Noli” në përmbushje të kërkesave të tregut të punës”*, u hartua pas një diskutimi të gjatë me grupin e punës.

Përmbajtja e pyetëtorit u fokusua në 3 drejtime kryesore / seksione:

- Informacione të përgjithshme
- Opinioni juaj mbi programin e studimit që keni zhvilluar
- Vlerësim i përgjithshëm për UK dhe mbështetjen që ai ofron ndaj studentëve

Në secilin seksion, janë grupuar kategori pyetjesh për marrjen e informacioneve të nevojshme mbi statusin aktual të të diplomuarve, punësimin, programin e përfunduar, bashkëpunimin me institucionin, përmbajtjen e programeve, kapacitetet e institucionit, zhvillimin e veprimtarive akademike në institucion, vlerësimin mbi aspekte të ndryshme bazuar në eksperiencat personale të secilit prej tyre. I plotë, pyetëtori i studentëve të diplomuar jepet në Raportin analitik.

Metodologjia e ndjekur në shpërndarjen e pyetëtorit bazohet në aksesin individual nëpërmjet internetit, ku çdo përdoruesi nëpërmjet e-mailit, iu vu në dispozicion adresa për të aksesuar pyetëtorin. Në platformën e institucionit bashkëpunues (Instituti për Cilësi në Arsim - IQE), u ndërtua pyetëtori dhe u shpërnda tek të diplomuarit. Pyetëtori është shpërndarë në datë 05.07.2022 dhe ka qënë i aksesueshëm deri në datën 30.07.2022.

Nga 4458 e-maile të dërguar, rezultuan të suksesshëm, 757 e-maile dhe 26% e tze u përgjigjën.

Konstatimi i parë që rezultoi është fakti se, adresat e e-mailit që ka institucioni në databazën e vet, mund të mos jenë aktive ose në përdorim nga studentët. Në këtë rast, institucioni duhet të gjejë mekanizmat se si studentët e diplomuar të përditësojnë kontaktet e tyre në mënyrë që të rritet ndërveprimi me institucionin.

Analiza është ndërtuar mbi numrin e të diplomuarve të cilëve iu përcoll linku për plotësimin e pyetëtorit Kampioni përbëhej prej 26% të studentëve të kontaktuar. Meqënëse pyetëtori nuk ka qënë

detyruet, disa nga pjesëmarrësit nuk kanë dhënë përgjigje të plota për të gjitha pyetjet.

Ne konsiderojmë pjesëmarrjen prej 26% një kampion të mjaftueshëm dhe të besueshëm për të nxjerrë konkluzione statistikore dhe për të bërë interpretimin e tyre. Sigurisht, grupi i punës nuk përjashton ndikimin tek studentët të përvojave personale pozitive apo negative të cilat në ndonjë rast mund të mos paraqesin realitetin sikundër ai është, por në tërësi ne gjykojmë se rezultatet e mëposhtme, kanë besueshmëri të lartë dhe duhet të studiohen dhe analizohen nga institucioni.

Sikundër kemi përmendur, ne kemi pyetur studentët se ku banojnë aktualisht. Rezulton se në përqindje shumë të lartë, studentët e UK vijnë kryesisht nga Qarku i Korçës, qytetet Korçë, Pogradec, Maliq.

Studentët e diplomuar që kanë marrë pjesë në pyetësor janë të fushave të ndryshme me shpërndarjen. Ndërkohë, pyetjes për statusin aktual të punësimit, të diplomuarit i kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Përqindja e punësimit të studentëve që kanë përfunduar studimet në UK ose angazhimit të tyre, rezulton se rreth 14% janë punësuar në një institucion publik me profilin e studimeve. 7.2 % në institucion privat në profilin e studimeve; 22% janë jashtë profilit ose kanë biznes privat, rreth 30 % janë duke kërkuar një punë dhe rreth 10 % kanë emigruar.

Pyetjes se ku janë punësuar aktualisht, rezulton se 33 %, janë punësuar në qarkun e Korçës ndërsa 56 % jo. Lidhur me pyetjen sa të kënaqur janë me punë që kryejnë, rezulton se vetëm 28% janë të kënaqur, 27 % jo dhe 45% nuk janë përgjigjur.

Pyetjes nëse pas përfundimit të studimeve, a keni patur mundësi të trajnoheni apo merrni pjesë në veprimtari të organizuara nga UK me qëllim zhvillimin tuaj të mëtejshëm profesional, vetëm 18% e studentëve i janë përgjigjur se kanë zhvilluar të paktën një trajnim nga UK.

Përfshirja e studentëve të diplomuar nga institucioni në veprimtari të ndryshme të zhvilluara prej tij, rezulton të jetë në nivel të kënaqshëm

Pyetja e fundit për seksionin 1 të pyetësorit, lidhet me mendimin aktual të studentëve për UK, nëse ai është i njëjtë me atë të fillimit të studimeve. Rezulton se 44 % e studentëve kanë të njëjtin vlerësim. Ky vlerësim është afërsisht i njëjtë (46%) me pyetjen e bërë në fund të pyetësorit nëse UK i ka përmbushur pritshmëritë e studentëve.

Në seksionin 2, të pyetësorit janë përzgjedhur një grup pyetjesh që lidhen me *“A mendoni se programi që keni ndjekur përsa i përket*

përmbajtjes dhe orientimit, reflekton më së mirë kërkesat dhe nevojat që ju apo tregu i punës ka?"

Studentët mendojnë se programet që kanë përfunduar i përgatisin ata për tregun e punës pasi rreth 45% e studentëve që kanë marrë pjesë në pyetësor, mendojnë se programi reflekton kërkesat që tregu ka.

Lidhur me kapacitetet pritëse, vlerësohet mirë infrastruktura e universitetit por ndërkohë vlerësim më të ulët ka bashkëpunimi me partnerët dhe biznesin.

Vlerësimi për personelin akademik nga studentët e diplomuar është mjaft pozitiv,

Në seksionin 3 të pyetësorit, studentët e diplomuar kanë vlerësuar mbështetjen e institucionit gjatë studimeve.

Pyetjes nëse ju ka mbështetur universiteti për punësim gjatë studimeve tuaja, dukshëm rezultati nuk është pozitiv me rreth 68 % të studentëve që mendojnë se mbështetja ka munguar.

Edhe lidhur me vlerësimin për përgatitjen profesionale për tregun e punës, vlerësimi është në nivelin mesatar.

Në përfundim të pyetësorit, të diplomuarit kanë dhënë vlerësimin e përgjithshëm për institucionin. Rezulton se pritshmëritë e 46 % të të anketuarve, janë përmbushur nga ana e institucionit. Ndërkohë 51% e tyre mendojnë se institucioni i ka përmbushur nevojat e rajonit për profesionistë të fushave të ndryshme.

Në përgjithësi, vlerësimi i studentëve të diplomuar është pozitiv për institucionin. Veçanërisht, pozitivisht vlerësohet personeli akademik dhe infrastruktura që institucioni ka vënë në dispozicion për zhvillimin e veprimtarive akademike. Përmbajtja e programeve vlerësohet mesatarisht pasi studentët gjejnë mangësi në orientimin e programeve drejt përgatitjes profesionale, praktikës etj.

Në pyetjen: bazuar në eksperiencën tuaj të deritanishme dhe njohjen që keni për institucionin, çfarë mendimi keni për përgatitjen e studentëve të diplomuar në programet e tjera të ofruara nga UK, vlerësimet janë kryesisht pozitive.

Studentët janë të paqartë lidhur me përgatitjen për tregun e punës pasi nga njëra anë ata mendojnë se programet i përgatisin me kompetencat për punësim, ndërkohë shprehen se janë përgatitur profesionalisht për tregun e punës në nivelin mesatar.

Një tregues tjetër që ka nevojë të adresohet sipas studentëve, është lidhja e institucionit me tregun e punës dhe biznesin. Pavarësisht se ka një numër të madh bashkëpunimesh, rezulton se institucioni nuk ka lidhje të forta me tregun e punës dhe biznesin. Mungesa e

praktikës profesionale sipas studentëve, duhet të adresohet në të ardhmen.

Në disa pyetje, të diplomuarit kanë shprehur mendimin e tyre nëpërmjet komenteve të lira. Mjaft interesante janë komentet e bëra për disa tregues për funksionimin e institucionit. Edhe pse vlerësimi i personelit akademik është pozitiv, të diplomuarit komentojnë se profesorët e vjetër në disa raste nuk ruajnë etikën e komunikimit me studentët, nuk i bëjnë orët e mësimit tërheqëse dhe nuk janë bashkëpunues me studentët etj.

Në komente, të diplomuarit shprehen për ndryshime mjaft pozitive në infrastrukturë, laboratorë të ndërtuar por që përdoren pak ose aspak. Ata shprehen se nuk i kushtohet rëndësi praktikës profesionale dhe se kanë bërë shumë pak ose fare (ndoshta ka ndikuar edhe pandemia Covid 19 në këtë drejtim).

Ata shprehen se disa programe nuk kërkohen nga tregu i punës dhe se u është dashur të bëjnë kurse për t'u punësuar në profesione të tjera. Ndërkohë ata propozojnë që institucioni të orientohet në ofrimin e programeve dhe kualifikimeve drejt teknologjisë, energjisë së rinovueshme etj

Disa komente mbartin vlerësime bazuar mbi eksperiencën personale. Ne mendojmë që institucioni të marrë në analizë komentet e dhëna në mënyrë anonime nga studentët për parë në tërësi cilat prej vërejtjeve apo konstatimeve të studentëve janë të vërteta dhe që kanë nevojë të adresohen në të ardhmen.

Institucioni duhet të angazhohet maksimalisht në përmirësimin e imazhit tek studentët, të diplomuarit dhe mandej tek studentët e rinj. Studentë të pakënaqur ndikojnë negativisht në rritjen e interesit për të studiuar në UK.

Për kryerjen e një studimi gjithëpërfshirës, Grupi i punës ka marrë edhe mendimin e përfaqësuesëve të tregut të punës. Opinioni i aktorëve kryesorë të zhvillimit ekonomik, arsimor, social-kultoror, bashkive dhe komunave në përbërje të Qarkut të Korçës, është shumë i rëndësishëm.

Për marrjen e mendimit të tyre u zhvilluan disa takime me përfaqësues të institucioneve arsimore publike e jopublike, institucioneve shtetërore, njërive vendore, përfaqësues të biznesit etj. Grupi i punës gjykoi të nevojshme, se për të patur një opinion sa më të gjërë dhe gjithëpërfshirës, të zhvillojë pyetësorin e titulluar "*Mendimi i partnerëve dhe bashkëpunëtorëve: Studimi i tregut të punës në rajonin juglindor dhe analiza e kapaciteteve të universitetit "Fan S. Noli" në përmbushje të kërkesave të tregut të punës*".

Përmbajtja e pyetësorit u fokusua në 3 drejtime kryesore / seksione:

- Informacione të përgjithshme
- Opinioni juaj mbi programin e studimit të ofruar nga UK
- Vlerësim i përgjithshëm i institucionin dhe studentët e diplomuar

Në secilin seksion, janë grupuar kategori pyetjesh për marrjen e informacioneve të nevojshme. I plotë, ky pyetësor jepet në Raportin analitik.

Edhe në këtë rast, metodologjia e ndjekur në shpërndarjen e pyetësorit bazohet në aksesin individual nëpërmjet internetit ku çdo përdoruesi nëpërmjet e-mailit iu vu në dispozicion adresa për të aksesuar pyetësorin. Në platformën e IQE, u ndërtua pyetësori respektiv. Pyetësori është shpërndarë në datë 05.07.2022 dhe ka qënë i aksesueshëm deri në datën 30.07.2022.

Nga ana e institucionit, janë vënë në dispozicion rreth 158 e-maile, përfaqësues të partnerëve dhe bashkëpunorëve të UK si shkolla, institucione të qeverisjes vendore, biznese, spitale/qendra shëndetësore, klinika, ferma etj.

Pjesëmarrja në pyetësor ka qënë shumë e ulët, rreth 5.9 % ku përsëri mjaft e-maile rezultuan të papërdorshëm ose të pasuksesshëm në dërgimin e e-mailit të njoftimit. Pjesëmarrja më e madhe e përfaqësuesve ka qënë nga bashkitë Korçë, Pogradec, Bilisht.

Në përqindjen më të lartë morën pjesë përfaqësues të institucioneve të qeverisjes vendore dhe organizma të tjerë, kompani/biznese private etj.

Rreth 50 e përfaqësuesëve të biznesit/partnerëve që morën pjesë në pyetësor, rezulton se janë diplomuar në UK

Në vijim janë paraqitur disa rezultate që lidhen me bashkëpunimin e institucionit të tyre me UK. Konkretisht, partnerët janë pyetur nëse kanë marrë pjesë në veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional të tyre. 87% e tyre shprehen se nuk kanë patur ndonjë eksperiencë të tillë. Referuar të dhënave të paraqitura, dalin në pah disa rezultate të rëndësishme.

Edhe pse pjesëmarrja është e ulët, këto rezultate japin informacione të vlefshme për UK parë nga këndvështrimi i partnerëve dhe biznesit. Partnerët dhe biznesi e shohin UK aktor të rëndësishëm për rajonin juglindor.

Edhe pse nuk kanë përfitime të drejtpërdrejta nga bashkëpunimi me UK, ata konfirmojnë se niveli i punësimit të studentëve të Korçës në institucione/bizneset e tyre varion nga 25-50 %. Për biznesin e vogël

ose institucionet me pak punonjës, niveli i punësimit të të diplomuarve nga UK arrin deri 50%.

Partnerët dhe biznesi vlerësojnë kapacitetet që ka UK përsa i përket personelit akademik dhe infrastrukturës por ndërkohë vlerësojnë si të përgatitur mesatarisht studentët e UK nga ana profesionale. Ata mendojnë se studentët janë përgatitur kryesisht nga ana teorike (rreth 80 % mendojnë se programet kanë përmbajtje kryesisht teorike).

Edhe në komentet e tyre, ata shprehen se institucioni duhet të fokusohet më shumë në përgatitjen praktike dhe profesionale të studentëve për tregun e punës.

Në seksionin 4, ne kemi analizuar të gjithë vlerësimet e dhëna nga studentët e diplomuar, partnerët dhe ekspertët e vlerësimit.

3. Vlerësime dhe rekomandime të ekspertëve të jashtëm për UK dhe programet

UK si pjesë e sistemit arsimor në Republikën e Shqipërisë, funksionon në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në arsimin e lartë. UK ka lirinë akademike të funksionimit dhe njëkohësisht përgjegjësinë për ofrimin e një arsimi cilësor për studentët dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës.

Referuar Statutit dhe Rregullores së UK, institucioni ka ngritur strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë si dhe përdor mekanizma të ndryshëm për sigurimin e brendshëm të saj.

UK bashkëpunon ngushtësisht me institucionet e sigurimit të jashtëm të cilësisë si Agjencia e Sigurimit të Cilësisë (ASCAL) dhe Bordin e Akreditimit.

UK rezulton të jetë një nga institucionet me angazhim maksimal për përmbushjen e standarteve të cilësisë, pjesë e Kodit të Cilësisë, miratuar në vitin 2021. Ai ka qënë pjesë integrale e proceseve të vlerësimit për licensimin e programeve të reja, akreditimin e tyre dhe akreditimin institucional.

Angazhimi i ekspertëve të jashtëm nga ASCAL, gjatë proceseve të ndryshme që ka zhvilluar institucioni, kanë ndihmuar UK të përmirësohet vazhdimisht në disa tregues të rëndësishëm.

Në akreditimin e parë të zhvilluar në vitin 2017⁵ ku UK ka marrë një nga vlerësimet më pozitive nga institucionet publike në vend me kohëzgjatje 5 vjet, ekspertët kanë sugjeruar prioritizimin dhe koordinimin e fushave kërkimore brenda departamentit ndërmjet stafit akademik dhe studentëve⁶. Ndërkohë, ekspertët kanë vlerësuar pozitivisht angazhimin e personelit akademik, fokusimin në zhvillimin e infrastrukturës së institucionit dhe asaj mbështetëse të institucionit, fokusimi në përmirësimin e mësimdhënies etj, tregues të cilët aktualisht rezultojnë në nivel të kënaqshëm, bazuar edhe në vlerësimet e të diplomuarve dhe partnerëve.

UK, është në proces të vendimmarrjes për ri-akreditimin institucional dhe të disa programeve të studimit. Ka përfunduar procesi për programet: [*Bachelor Biologji - Kimi, Bachelor Menaxhim, Bachelor Gjuhë Angleze, Bachelor Inxhinieri, Agronomike, Bachelor Financë - Kontabilitet, Bachelor Agrourbim, Bachelor Mësuesi për arsimin fillor Kl. I-VI, Bachelor Administrim dhe Politika Sociale, Diplomë profesionale Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershmeramet*]⁷.

Nga analiza e raporteve të vlerësimit të jashtëm të secilit program, bazuar në vlerësimet e ekspertëve dhe analizën SWOT, evidentohen tregues në të cilët institucioni performon mirë si dhe treguesit që duhen përmirësuar.

Si pika të forta të institucionit, vlerësohet funksionimi në përputhje me aktet ligjore në fuqi, infrastruktura dhe logjistika në dispozicion të mësimdhënies, personeli akademik dhe angazhimi i tij në disa programe, bashkëpunimi në nivel kombëtar në disa programe, infrastruktura laboratorike.

Ndërsa pika të dobëta evidentohen nevoja për përshtatjen e programeve me tregun e punës, hartimi i tyre në përputhje me nevojat e tij, rishpërndarja e programeve në përputhje me profilin e njësisë kryesore dhe bazë, kryerja e sa më shumë orëve laboratorit dhe praktike profesionale, përfshirja e biznesit dhe studentëve në rishikimin e programeve, shpërndarja e programeve në njësi bazë në

5

https://www.ascal.al/index.php?option=com_k2&view=item&layout=item&id=94&Itemid=698&lang=sq

⁶ https://www.ascal.al/media/documents/rvj/IAL_53_50.pdf

7

https://www.ascal.al/index.php?option=com_k2&view=item&layout=item&id=94&Itemid=698&lang=sq

përputhje me profilin e tyre, përfshirja e studentëve dhe mbështetja e tyre për punësim etj.

Në tërësi, disa nga gjetjet dhe konstatimet në raportet e vlerësimit të jashtëm, janë në të njëjtën linjë me konkluzionet e nxjerra ky studim. Orientimi i politikave të institucionit në përmirësimin e disa treguesëve, do të ndihmojë institucionin të rrisë performancën e vet dhe t'i shërbejë më shumë rajonit juglindor dhe vendit.

IV. ANALIZA E TREGUESËVE KRYESORË PËR ORIENTIMIN E PROGRAMEVE DREJT TREGUT TË PUNËS, GJETJE DHE REKOMANDIME

1. Statusi aktual i programeve të UK dhe përputhshmëria me strategjitë rajonale e kombëtare të zhvillimit

Në seksionin 2, ne kemi paraqitur programet e studimit të UK. Programet kanë shpërndarje të ndryshme sipas fushave kryesore të studimit që ofron Universiteti i Korçës. Sikundër është evidentuar edhe nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm, ka programe profili i të cilave nuk përputhet me fushën e veprimtarisë së njësisë kryesore ose atë bazë

Nga analiza jonë, ne kemi evidentuar se në disa programe të UK, konkurenca është e madhe me institucionet e tjera dhe është e nevojshme që institucioni të marrë në konsideratë numrin e programeve të ngjashme që ofrohen nga institucionet e tjera.

Nga ana tjetër, edhe MAS, si institucioni përgjegjës për politikat arsimore, licensimin e programeve dhe shpërndarjen e kuotave të studimit për çdo fushë, program institucion, nuk rezultojnë të ndjekë një politikë të qartë të alokimit të kuotave duke marrë në konsideratë, nevojat kombëtare për profesionistë të caktuar, institucionet që ofrojnë programe të ngjashme apo të përafërta në mënyrë që të mundësojë funksionimin normal të institucioneve publike dhe të orientojë maturanët në programe që ofrohen nga institucione të cilat kanë kapacitet, infrastrukturë dhe logjistikë më të mirë lidhur me atë drejtim.

Duke përjashtuar disa institucione me orientim të qartë në profilet arte, sporte, inxhinieri, pothuaj të gjitha institucionet e tjera, ofrojnë të njëjtat programe e profile.

Programe të njëjta ose të përafërta të licensuara në shumë institucione publike e private, kanë krijuar vështirësi në institucionet rajonale që të jenë konkures për të ofruar programe specifike që lidhen me rajonin dhe veçoritë që ai ka.

Në vlerësimin tonë, institucionet politikëbërëse (në këtë rast MAS) duhet të ndër marrë masa konkrete për të faktorizuar institucionet rajonale në fusha dhe drejtime specifike me interes kombëtar duke orientuar maturanët të ndjekin programe të caktuara në institucione të caktuara.

Nëse programet më pak të kërkuara ofrohen njëkohësisht nga disa institucione publike e private kryesisht në Tiranë atëherë, mundësitë

për institucionet rajonale, janë të vogla, përveç rasteve kur faktorë të tjerë ndikojnë në zgjidhjen e tyre si.p.sh. situata ekonomike.

Sigurisht në këtë analizë ne nuk kemi anashkaluar edhe faktorët brenda institucionit por rezulton se dy problematikat që lidhen me numrin e programeve dhe numrin e kuotave, luajnë rol parësor në uljen e interesit të maturanëve. Ne sugjerojmë që t'i propozohen MAS mekanizma rregullues për programet dhe kuotat veçanërisht për programet me interes kombëtar.

Në këtë studim nuk kemi marrë në konsideratë përmbajtjen e programeve por kemi analizuar kryesisht profilin e tyre dhe përputhshmërinë e tregut të punës.

Referuar të dhënave të INSTAT, për regjistrimet e studentëve në vitin akademik 2021-2022 sipas fushave të studimit, dukshëm interesi i studentëve është fokusuar në drejtimet kryesore: Shkenca ekonomike, shkenca inxhinierike dhe shkencat e shëndetit

Në përgjithësi programet e UK përfshihen në fushat e kërkuara nga maturanët dhe që tregu ka nevojë për to.

Miratimi i një numri të madh kuotash në fushat dhe programet më të kërkuara siç janë shkencat mjekësore, inxhinierike dhe ekonomike, bën të mundur regjistrimin e kontigjentit më të madh të maturanëve në këto programe, duke lënë si zgjedhje të dytë programet e fushave të tjera sikundër janë shkencat natyrore, sociale e bujqësore. Kjo reflekton dhe nivelin e ulët të maturanëve që aplikojnë në programet e studimit të UK.

Në këtë vit akademik, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një hap konkret me qëllim mbështetjen e fushave prioritare dhe të programeve të studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer, e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë (VKM 386, 1.6.2022, shtojca nr. 1). Ky vendim mbështet studentët që duan të studiojnë në universitetet publike në programe të ndryshme dhe interesit si shkenca humane, shkenca natyrore, inxhinierike, bujqësi, veterinari, shërbime, etj ku shumë prej tyre përfshihen në listën e programeve të ofruara nga UK.

Institucioni duhet të shfrytëzojë këtë instrument mbështetës për studentët në radhë të parë dhe për institucionet gjithashtu. Politika promovuese, stimuluese, mbështetëse, përtej asaj financiare të shpallur nga qeveria shqiptare, duhet të jenë pjesë e aktivitetit të përditshëm të institucionit. UK duhet të krijojë frymë pozitive tek studentët (shih paragrafin 3 në vijim), të demostrojë se ka interes dhe i mbështet ata për ecurinë në karrierë.

Kërkesa e studentëve në një program studimi, është tregues i suksesit ose jo të programit. Nëse programi është pjesë e programeve që përbëjnë prioritet kombëtar, atëherë institucioni duhet të shfrytëzojë këtë mundësi për mbajtjen në funksionim të drejtimeve që janë pak të kërkuara nga studentët. Ndërsa për programet e tjera, të cilat për disa vite rresht reflektojnë interes të ulët, institucioni duhet të rishikojë statusin e tyre që nënkupton riorganizimin dhe përshtatjen me tregun e punës, ndryshimin e profilit, promovimin etj.

Një kërkesë e rëndësishme që duhet të përmbushin programet e studimit të ofruara nga UK është hamonizimi i përmbajtjes së tyre në përputhje me strategjitë e zhvillimit. Nëse i referohemi strategjisë kombëtare të arsimit 2021-2026 (draft)⁸, janë përcaktuar disa objektiva që duhet të përmbushë arsimit i lartë në vend si:

- Rritja e cilësisë së arsimit të lartë, nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit, modernizimit të infrastrukturës akademike dhe aplikimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit. Arsim i lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.
- Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.
- Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës.
- Sigurimi i integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e arsimit të lartë.
- Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare.
- Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë në Shqipëri dhe integrimi në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).
- Avancimi i infrastrukturës së TIK-ut dhe i shërbimeve digjitale për IAL publike. Prioritetet e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022 për arsimin e lartë ndërlidhen me sigurimin e cilësisë.
- Gjetja e mekanizmit për të garantuar përfshirjen më të gjerë të palëve të interesuara në sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.
- Hartimi i kornizës ligjore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në rrafshin ndërkufitar dhe akreditimin e programeve të përbashkëta.

⁸ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026-1.pdf>

Ndërsa objektiv specifik është rritja e cilësisë së arsimit të lartë nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit, modernizimit të infrastrukturës akademike dhe aplikimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit.

Sikundër shihet, në terma afatgjatë, strategjia në arsimin e lartë është fokusuar në aspekte cilësore të ofertës akademike, rritjen e cilësisë dhe reputacionit të institucioneve përmes ndërkombëtarizimit.

Në përputhje me këto objektivat madhorë, edhe UK duhet të rishikojë strategjinë e vet të zhvillimit në mënyrë që ajo të reflektojë jo vetëm objektivat që strategjia kombëtare ka por të harmonizohet me strategjitë rajonale dhe kombëtare të zhvillimit ekonomik.

Në strategjinë e vet, UK duhet të marrë në konsideratë drejtimet kryesore në të cilat do të zhvillohet institucioni në 10 vitet e ardhshme. Bazuar në të dhënat e mësipërme, UK ndikimin më të madh e ka në rajonin juglindor dhe në këtë kontekst sugjerojmë që strategjia e zhvillimit duhet të ndërtohet në funksion të zhvillimit të këtij rajoni përfshirë dhe atë ndërkufitar.

Paralelisht, ne mendojmë se është e nevojshme të ndërmerren hapa konkrete në profilizimin e programeve sipas fushave të përcaktuara në strategjinë institucionale e mandej, ato të përmirësohen në përmbajtje. Programet e reja apo rishikimi i atyre ekzistuese, të bazohen mbi rezultatet e të nxënimit dhe të jenë të krahasueshme me programet e institucioneve evropiane. Për të unifikuar programet në përmbajtje, institucioni duhet të hartojë një metodologji për hapjen/rishikimin e programeve duke përfshirë procedurat që do të ndiqen si dhe procesin, fushat dhe kriteret në të cilat duhet të mbështetet institucioni në ofrimin e tyre (parashikuar edhe në strategjinë e sipërcituar).

Rishikimi dhe hartimi i programeve të studimit në përputhje me metodologjinë e hartuar, në themel duhet të ketë rezultatet e të nxënimit, aftësimin profesional dhe kompetencat që studentët duhet të arrijnë në përfundim të studimeve. Në harmoni me praktikën më të mira evropiane, edhe ngarkesa e krediteve ECTS duhet të lidhet me rezultatet e të nxënimit, e jo vetëm me ngarkesën e projektuar të studentit.

Metodologjia e hartuar, duhet të marrë në konsideratë disa elementë që duhet të kenë programet e studimit në zbatim të bazës ligjore në fuqi dhe strategjisë në arsimin e lartë si p.sh programet e studimit, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70

për qind, përcaktimin e fushës së përgjithshme të programit dhe fushës specifike të tij.

Gjithashtu, duhen patur parasysh njohuritë dhe profesioni që jep çdo nivel i KSHK (5,6,7,8) në mënyrë që përmbajtja e programeve të jetë në funksion të nivelit të studimit, diplomë profesionale, bachelor, master profesional e shkencor dhe doktoraturë⁹.

Përveç organizimit të programeve, është po aq e rëndësishme përmirësimi i metodologjisë së mësimdhënies, duke u fokusuar më shumë tek mësimdhënia cilësore, të mësuarit me në qendër studentin dhe përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies të ndërthurura me praktikat profesionale (specifikuar edhe në strategjinë për arsimin). Sikundër është evidentuar nga studentët e diplomuar dhe tregu i punës, programet aktuale kanë një orientim teorik dhe i përgatisin pjesërisht studentët me njohuritë dhe kompetencat e duhura profesionale.

2. Kapacitetet dhe mundësitë reale të punësimit në rajonin juglindor dhe reflektimi i kërkesave të tregut të punës

Punësimi i të sapodiplomuarve lidhet jo vetëm me aftësitë e tyre profesionale, por mbi të gjitha me ofertën e tregut të punës. Në vitet e fundit ka patur ndryshime të mëdha në lëvizjet demografike, emigrim, zhvillimin e biznesit, agrobiznesit dhe turizimit, çka ka sjellë ndryshime esenciale në ofertën e punësimit në rajonin tonë. Në analizën e kryer në seksion 2, janë përfshirë të dhëna mbi punëdhënësit kryesorë të rajonit, sektorin publik, sektorin privat, industrinë turistike, agro-përpunuese, bujqësinë, ndërtimin, etj, si dhe sektorë me potencial të lartë për punësimin e të diplomuarve.

Rezulton se sektori privat (përfshirë edhe bujqësinë) rezulton të jetë punëdhënësi më i madh. Ndërsa lloji i institucioneve që arrin të punësojë numrin më të madh të studentëve janë ndërmarrjet/institucionet e vogla me numër të ulët punonjësish. Ndërsa në total, të diplomuarit e Universitetit ë Korçës përbëjnë 30 - 50 % të punonjësve të që kanë bizneset, kompanitë e marra në studim.

Tregu i punës është i interesuar për profesionistë të kualifikuar të përgatitur kryesisht në programet profesionale, bachelor dhe master profesional. Në këtë kontekst, mendojmë se ky duhet të jetë edhe fokusi i institucionit përse i përket zhvillimit të programeve të reja, pa

përrjashtuar edhe programe specifike si master shkencor, master ekzekutiv apo doktoraturë.

Rajoni ka potencial të lartë zhvillimi, ku nevoja për profesionistë do të jetë e lartë në vitet më pas. Disa sektorë janë në zhvillim e sipër sikundër është industria e turizmit dhe shërbimeve. UK ka reflektuar këto zhvillime dhe aktualisht ofron programe që përgatisin profesionistë në funksion të tyre.

Zhvillimi i industrisë agropërpunuese, ka mundësi të mëdha zhvillimi në drejtime të ndryshme përsa i përket, grumbullimit, ambalazhimit, shpërndarjes, konservimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore e blektorale. Kjo industri në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndikon në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, rritjen e kapaciteteve prodhuese të saj, futjen e teknologjisë dhe automatizimit në bujqësi etj.

Pra, sektori bujqësi-blegtori-industri agropërpunuese, shihet si sektori me potencialin më të madh të zhvillimit e për rrjedhojë të punësimit nëse aplikohen metodat e reja teknologjike, inovacioni në prodhim dhe përpunim. UK ka aktualisht disa programe të orientuara në këto drejtime. Përfshirja e palëve të interesuara për reflektimin sa më mirë të kërkesave që ky treg ka, duhet të konsiderohet si mundësi për konsolidimin e këtyre programeve në të ardhmen.

Një tjetër sektor që ka kontribuar më shumë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe njëkohësisht ka potencialin më të lartë të zhvillimit dhe punësimit në të ardhmen, është sektori shërbimeve dhe turizmit. Ky sektor është i lidhur në mënyrë integrale me sektorin bujqësi-blegtori-industri agropërpunuese. Rritja e shërbimeve turistike, rrit kërkesën për produkte bujqësore dhe nga ana tjetër rritja e cilësisë dhe gamës së produkteve ushqimore, ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kulinarisë dhe ushqimit. Universiteti i Korçës duhet të luajë rol promotor në aplikimin e teknikave dhe teknologjive inovative në këta sektorë të ekonomisë, duke bashkëpunuar me aktorët e këtyre sektorëve, duke iniciuar projekte që synojnë përdorimin e teknologjisë dhe rritjen e standarteve të prodhimit. Krijimi i një njësie/strukture që merret me aplikimin e projekteve dhe zbatimin e tyre, duhet të shihet me përparësi.

Sektori arsimor e shëndetësor, është i lidhur ngushtësisht me numrin e popullsisë e për rrjedhojë ato nuk kanë premisa të zgjerimit të kontributit të vet në punësimin e studentëve të diplomuar. Për më tepër, për shkak të tkurrjes së numrit të popullsisë, në vitet në vijim

mund të kemi reduktim të numrit të punonjësve në sektorin publik sikundër është p.sh numri i mësuesëve, edukatoreve, infermierëve etj. Duke marrë në konsideratë, numrin e punonjësve që largohen nga sistemi për shkak të daljes në pension, migrimit të brendshëm apo emigrimit (p.sh infermierët), numri total i vendeve të reja të punës që hapen çdo vit në sektorin publik, janë lehtësisht të llogaritshme. Në këtë kontekst, UK duhet të mundësojë plotësimin e vendeve vakante të krijuara vit pas viti duke marrë në konsideratë dhe numrin e studentëve të diplomuar nga rajoni në universitetet e tjera brenda vendit por edhe jashtë tij.

Industria prodhuese ka potenciale të mëdha zhvillimi në perspektivën afatgjatë, Drejtimet në të cilat mund të zhvillohet janë prodhimi i materialeve të ndërtimit, prodhimit të lëndëve të para, elektronika dhe energjtika. Zhvillimi i tyre kërkon investime të mëdha dhe politika afatgjata të hartuara nga qeveria në nivel kombëtar. Meqënsëse ky sektor kërkon të diplomuar me kualifikim të lartë (inxhinierë, etj), fokusimi i institucionit në planin afatshkurtër, nuk shihet të ketë përparësi.

Në planin afatshkurtër, drejtime specifike të teknologjisë së informacionit dhe aplikimeve saj në fusha të ndryshme të ekonomisë, ka potenciale të mëdha punësimi pavarësisht se impakti i këtij sektori, në punësimin e të diplomuarave aktualë, është relativisht i ulët. Në fazën e rishikimit të programeve/ riorganizimit të tyre apo hapjes së programeve të reja, një studim i dedikuar duke përfshirë dhe kompanitë kryesore të fushës së teknologjisë së informacionit, është i nevojshëm.

Përsa i përket sektorit të ndërtimit, ai do të ruajë të njëjtat raporte në kontributin e përgjithshëm ekonomik të rajonit. Ndërkohë për shkak të largimeve masive të profesionistëve brenda vendit apo në emigrim, nevoja për profesionistë të kualifikuar, do të jetë emergjente. Largimi i punonjësve të kualifikuar, aplikimi i teknologjive të reja në ndërtim, rritja e volumit të ndërtimeve/restaurimeve, krijon një potencial të madh për universitetin të fokusohet në programet e formimit profesional, trajnimeve afatshkurtra dhe kualifikimeve profesionale specifike.

Në bashkëpunim me biznesin, UK duhet të orientojë politikat e veta në formimin e teknikëve, profesionistëve të në sektorin e ndërtimit, mirëmbajtjes, shërbimeve.

Në përfundim, theksojmë se tregu i punës është prekur nga ndikimet që sjell globalizmi, liria e lëvizjes dhe e drejta për punësim. Proceset integruese që aktualisht vendi është duke ndjekur si ai për anëtarësim në BE, Open Balkan, lehtësira për punësim në vendet fqinje etj, krijojnë premisa për lëvizshmëri të lartë të profesionistëve të çdo fushe.

Nevoja për të kualifikuar, veçanërisht për teknikë dhe profesionistë shërbimesh, është në rritje dhe kjo mund të shërbejë si mundësi e UK për të krijuar një grup programesh të formimit profesional, duke pranuar studentë përtej kërkesave që tregu rajonal ka. Nevoja dhe dëshira për të emigruar vazhdon të jetë e lartë dhe në këtë drejtim, UK duhet të marrë në konsideratë kërkesën për përgatitjen profesionale të tyre.


Për zhvillimin e programeve të reja dhe rishikimin e atyre ekzistuese, institucioni duhet të bazohet mbi analizën e hendekut të kërkesës së tregut dhe se sa prej tyre plotësohen nga UK dhe institucionet e tjera. Tregu aktual i punës është në fokus të ofertës akademike jo vetëm të UK por edhe të 41 institucioneve të arsimit të lartë që operojnë në vend, të më shumë se 50 shkollave profesionale dhe qendrave të formimit profesional si dhe të studentëve që studiojnë jashtë vendit.

3. Mbështetja e studentëve për punësim, karrierë të suksesshme dhe promovimi i praktikave të mira


Për të tërhequr studentët e rinj, institucioni duhet të ketë parasysh që maturantët/prindërit, duan prova/detaje mbi vlerën reale të programeve që ofrohen nga ana e Universitetit të Korçës. Pavarësisht nivelit të besueshmërisë që mund të kenë rezultatet e marra nga pyetësi i studentëve të diplomuar, opinioni i ish studentëve është relativisht pozitiv.

Kjo do të thotë se ka vend për përmirësime në qasjen e institucionit ndaj studentëve. Edhe në raportet e vlerësimit të jashtëm ekspertët evidentojnë përmirësime të dukshme të bëra ndaj studentëve si: Infrastrukturë e përmirësuar, akses në shërbimet e institucionit, përkushtim nga ana e personelit akademik, mbështetja në veprimtari të ndryshme etj (analiza SWOT e raporteve), por përsëri evidentohen problematika të cilat ne i kemi evidentuar në seksionin 3.


Studentët e diplomuar kanë adresuar edhe shqetësime të tjera ku më kryesorja është mospërgatitja profesionale në nivelin e duhur, pasi programet e studimit kanë pak ose aspak të përfshirë veprimtari që lidhen me zbatime praktike, laboratorike dhe praktikën profesionale.



Ne e konsiderojmë të rëndësishme këtë problematikë në përmirësimin e imazhit të institucionit tek studentët e diplomuar. Këta studentë janë njëkohësisht promovuesit më të mirë ose më të keq të institucionit, pasi nëse pyeten nga të tjerët (maturantë ose prindër), mendimi i tyre besohet mjaft si ish studentë të institucionit dhe njohës të mirë të tij.



Në përmirësimin e këtij imazhi, institucioni duhet të analizojë perceptimet që lidhen me mësimdhënien, mosvlerësimin korrekt nga personeli akademik, forma të ndryshme të sjelljes joetike të stafit apo forma presioni, abuzimi etj, të cilat ndikojnë jashtëzakonisht në mënyrë negative në opinionin e përgjithshëm.



Një tjetër tregues që duhet të ketë vëmendje nga ana e institucionit është mbështetja e studentëve për punësim dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës.

Universiteti ka njësi të dedikuara që kanë në fokus studentët dhe asistimin e tyre për tregun e punës. Rezulton se vetëm 23% e tyre janë orientuar për punësim gjatë studimeve të tyre.

Nëse UK nuk ka dëshmi të forta për suksesin e të diplomuarve, eksperiencat të ndryshme, statistika etj, institucioni nuk është në gjendje të krijojë besim tek studentët dhe tregu i punës.

Për këtë qëllim, institucioni duhet të analizojë të dhënat e punësimit ndër vite, në mënyrë që të evidentohen rastet që mund të mund të promovohen si histori suksesi.

Nga ana tjetër, studentët duhet të përgatiten psikologjikisht për tregun e punës, për sjelljen dhe etikën e punës, të mbështeten të aplikojnë, të përgatisin dokumente dhe të intervistohen.

Mënyra më e mirë është angazhimi i studentëve të diplomuar që kanë një karrierë të suksesshme, në mënyrë që ata të shërbejnë si promovues të institucionit duke prezantuar para studentëve eksperiencat e veta në universitet apo jashtë tij (shkolla, evente të ndryshme). Në këtë mënyrë institucioni promovon vlerat e veta

nëpërmjet shembujve konkretë duke krijuar besueshmëri tek studentët që studiojnë apo tek maturanët në shkollat e mesme.

Angazhimi i studentëve të diplomuar në forma të ndryshme në institucion është sfidë, pasi shumica, sapo mbarojnë studimet, ndërpresin marrëdhëniet dhe kontaktin me universitetin. Kjo u vërtetua dhe nga përqindja e ulët e pjesëmarrjes në pyetësor dhe nga e-maillet e gabuara/të papërditësuara.

Edhe pse është sfidë ruajtja e marrëdhënieve me studentë e diplomuar, bashkëpunimi me ta është i vyer për mendimin dhe eksperiencat që sjellin. Përveç ftesave të ndryshme për pjesëmarrjen në veprimtari që organizon universiteti, ata mund të bëhen pjesë e grupeve të punës për diskutimin e programeve, pjesë e studimeve dhe projekteve, të ftohen të kontribuojnë në veprimtari të ndryshme si asistentë, tutorë dhe mentorë për praktikat profesionale. Në këtë mënyrë, rritet interesi i tyre për institucionin dhe njëkohësisht përmirësohet imazhi i institucionit.

4. Roli i UK si nyje lidhëse midis tregut të punës, studentëve dhe të diplomuarve të vet


Universiteti i Korçës rezulton të ketë një rrjet të gjerë partnerësh dhe bashkëpunorësh jo vetëm në rajonin juglindor por në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Si institucion i vetëm në qarkun e Korçës, pesha që zë universiteti në jetën ekonomike, social-kulturore e shkencore, është e padiskutueshme.

Nëse bashkëpunimi në nivel institucional është në nivele të kënaqshme, këto bashkëpunime nuk reflektohen në përfitime për studentët. Lidhja e studentëve me tregun e punës qysh në vitin e parë të studimeve, i ndihmon ata të krijojnë perceptime, kontakte dhe komunikime me përfaqësues të biznesit.

Nga ana tjetër biznesi dhe përfaqësues të tregut të punës, bëhen pjesë aktive e edukimit të studentëve në bazë të interesit që ata kanë. Përfshirja e biznesit mund të përmirësojë perceptimin e vet biznesit dhe studentëve mbi përgatitjen e tyre për tregun e punës.

Sikundër kemi paraqitur në seksionin 3, mendimi i partnerëve dhe i bashkëpunorëve është se në përgjithësi studentët e diplomuar janë përgatitur mesatarisht për tregun e punës.

Bazuar në eksperiencën tuaj të deritanishme për studentët e diplomuar nga Universiteti i Korçës, sa mendoni se ata janë të përgatitur profesionalisht për tregun e punës?



Ndërveprimi i studentëve me biznesin, institucionet etj, që në ditët e para të studimeve, kontribuon në edukimin e tyre me vizionin e karrierës, i motivon të përfundojnë me sukses studimet e tyre.

Ata përgatiten më mirë profesionalisht duke krijuar vetëbesim, aftësi dhe kompetenca. Në këtë mënyrë rritet besimi i studentëve për institucionin dhe i biznesit ndaj studentëve të diplomuar nga ana e UK. Nëse aktualisht studentët e diplomuar në UK përbëjnë rreth 30 % të të punësuarve në institucione, ndërmarrje dhe bizneset e vogla, ekzistojnë mundësitë që ky rol të rritet.

Institucioni duhet të krijojë një databazë të gjërë të institucioneve partnere, kompanive e biznesit dhe t'i ftojë ata të promovojnë institucionet e tyre, të kontribuojnë në praktikat profesionale dhe intershipe.

Institucioni të shohë mekanizmat mbështetës për studentët që punësohen apo për kompanitë që punësojnë studentë edhe gjatë studimeve, veçanërisht për studentët master.

Oraret fleksibël të zhvillimit të veprimtarive mësimore, ndërthurja e metodave të edukimit në distancë me ato tradicionale, do të krijojnë lehtësira për përfshirje më të madhe të partnerëve në UK dhe të studentëve që janë në një marrëdhënie pune apo synojnë të punësohen gjatë studimeve të tyre.

5. Përspektiva e programeve e reja të studimit për përmbushjen e kërkesave të tregut të punës në qarkun e Korçës e më gjerë

Identifikimi saktë i drejtimeve kryesore në të cilat mund të orientohen programet e studimit, është kompleks.

Pavarësisht përpjekjeve tona për të mbledhur sa më shumë informacione rreth potencialit ekonomik të rajonit, mungojnë studime të mirëfillta ekonomike, zhvillimore nga institucione të specializuara të cilat mund të japin informacione shitesë mbi mundësitë e zhvillimit ekonomik të rajonit, prognoza, faktorët e riskut. Megjithatë, disa faktorë të jashtëm, impaktojnë ecurinë ekonomike të rajonit, zhvillimin e saj dhe punësimin. Konkretisht:

Faktorët politikë: Politikat ndërsektoriale të qeverisë, ato ekonomike e financiare, lidhen me planet buxhetore dhe tregues të tjerë që përcaktojnë ecurinë makro-ekonomike. Shqipëria ka normë të lartë të papunësisë të të rinjve. Sipas INSTAT 23.1% e të rinjve të moshës 15-29 vjeç ishin të papunë në vitin 2018, gjë që flet për nevojën e harmonizimit më të mirë të programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës. Shqipëria është e përgatitur mesatarisht në fushën e arsimit, duke sugjeruar përqëndrim të mëtejshëm në zbatimin e reformave në fushën e arsimit parauniversitar dhe të lartë.

Faktorët ekonomikë: Pandemia COVID-19, kriza ekonomike, tërmeti 2019, kanë ndikuar në rritjen ekonomike në vend. Recesioni dhe masat mbështetëse ekonomike parashikohet ta zgjerojnë deficitin duke kaluar në plan të dytë politikat ekonomike mbështetëse për arsimin, projektet e ndryshme infrastrukturore që zhvillohen, mbështetjen financiare për qarqet, bashkitë, komunat etj.

Për hapjen e programeve të reja, duhet kryer një analizë specifike për tregun e punës dhe kapacitetet që lidhen me atë profil. Ne sugjerojmë të merren në konsideratë Nomenklatura e Vepimtarive Ekonomike (NVE), për përcaktimin e qartë të profesionit dhe kategorisë veçanërisht për programet e karakterit profesional dhe faktorët e jashtëm të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin ose përkeqësimin e performancës së programeve.

Janë identifikuar disa drejtime orientuese në të cilat universiteti mund të fokusohet për hapjen e programeve të reja ose riorganizimin e programeve ekzistuese.

1. Formimi profesional nëpërmjet programeve profesionale rezulton të jetë mundësia më e mirë për punësimin e të rinjve në qarkun e

Korçës. Bazuar në gjetjet e këtij studimi, ekonomia aktuale e rajonit ka nevojë më së shumti për profesionistë dhe teknicienë për shërbime të ndryshme. Programet ekzistuese dhe të reja që do të hapen nga institucioni, kanë nevojë për mbështetje dhe promovim. Është e nevojshme të minimizohet stereotipi i të paturit të një diplome universitare bachelor apo master për t'u punësuar në pozicione të cilat nuk kanë nevojë për kualifikim të avancuar.

2. Zhvillimi i programeve të orientuara drejt teknologjisë, inovacionit, programimit, automatizimit. Ky sektor është mjaft premtues për t'u zhvilluar në të ardhmen. Edhe pse konkurrenca me institucionet e tjera në vend ose jashtë është e lartë, programe të reja të këtij drejtimi, duhet të hapen. Biznesi dhe tregu i punës tashmë është ndërgjegjësuar për përfitimet që sjell përdorimi i teknologjisë në optimizimin e kostove dhe kohës së shërbimeve apo produkteve. Ai has vështirësi në përdorimin e teknologjisë në menaxhim, komunikim e ndërveprim, prodhim etj, dhe UK mund të jetë mbështetësi dhe promotori kryesor i digjitalizimit të shërbimeve në rajonin juglindor. Përfshirja e aktorëve të biznesit në programet e studimit si palë të interesuara veçanërisht në ofrimin e praktikave profesionale, është faktor kyç në suksesin e këtyre programeve.
3. Aktualisht programet e fushës së bujqësisë, agro-ushqimit rezultojnë të mos jenë të preferuara nga studentët. Megjithatë, bazuar në profilin ekonomik që ka rajoni dhe në trendet e reja të zhvillimit ekonomik kombëtar, sektorë si bujqësia, industria agro-ushqimore e përpunuese, rezultojnë të jenë prioritare. Ato lidhen me industrinë e turizmit dhe shërbimeve të shpallura nga qeveria shqiptare si sektorë të zhvillimit strategjik të vendi në të të ardhmen. UK ka traditë shumëvjeçare në ofrimin e programeve të këtij profili, ka infrastrukturë laboratorike të ndërtuar prej shumë vitesh dhe personel akademik të kualifikuar. Këto mundësi dhe asetete duhet të vihen në përdorim nëpërmjet formave të ndryshme në mënyrë që të ringjallet interesi tek të rinjtë se këto programe jo vetëm garantojnë punësim, vetëpunësim të menjëhershëm, por do të jenë profesionet më të paguara sikundër rezulton edhe në vendet e tjera. UK mund të luajë rol koordinues për zbatimin e politikave në fushën e bujqësisë, sigurisë ushqimore dhe certifikimit aq i nevojshëm në kuadër të proceseve për anëtarësimin evropian. Përfshirja e profesionistëve të certifikuar në industrinë ushqimore e përpunuese, sikundër kërkohet në aktet ligjore në fuqi, do të rrisë numrin e të punësuarve nga ky

sektor. Futja e teknologjisë në sektorin e bujqësisë, automatizimi i proceseve të prodhimit, është mundësi e madhe për universitetin për të hapur programe të teknologjisë me aplikime në bujqësi dhe agropërpunim. Njëkohësisht, fondet mbështetëse nga EU dhe donatorë për projekte në këtë fushë janë rritur dhe kjo duhet të shihet si perspektivë mbështetëse për të inicjuar projekte të rëndësishme në partneritet me biznesin. Universiteti i Korçës, ka potencialin të vazhdojë të jetë një nga 2 qendrat e universitare në vend që mundëson kryerjen e studimeve, kërkimeve shkencore dhe promovimin e teknologjive të reja në bujqësi, agro-industri jo vetëm në rajon por edhe në nivel kombëtar e ndërkufitar.

4. Programet aktuale të orientuar drejt turizmit, shërbimeve, duhet të zhvillohen me drejtime të reja.
5. Programet e shkencave natyrore rezultojnë të jenë pak të kërkuara për shumë faktorë. Ato janë drejtime të vështira studimi që aktualisht nuk ofrojnë mundësi punësimi pas përfundimit të bachelorit. Meqënëse tregu i punës kërkon aftësi profesionale, ne mendojmë ndryshim të konceptit aktual të këtyre programve duke i orientuar më shumë drejt aftësimit profesional në drejtime të ndryshme me mundësi punësimi për të shërbyer si bazë e mirë studentësh për programet master jo vetëm në mësuesi por në drejtime të tjera të teknologjisë së informacionit, zbatimit të efijçencës energjitike, paneleve diellore e fotovoltaike, etj. Institucioni duhet të shfrytëzojë mbështetjen që jep qeveria shqiptare për studentët që studiojnë në këto programe studimi duke i promovuar këto programe, ku studenti jo vetëm nuk ka kosto financiare për studimet e veta, por mund të profilizohet në një drejtim që siguron punësim në të ardhmen.
6. Programet e mësuesisë për ciklin e ulët janë në traditën e institucionit e për të cilat duhet treguar interes i veçantë. Me mbështetjen e studentëve në kuadër të programeve me interes kombëtar, ekzistojnë mundësitë që ato të promovohen dhe përzgjidhen nga studentët. Numri i vendeve të punës është i limituar me potencial duke u ulur, çka ndikon në numrin e kuotave që duhen parashikuar
7. Programet aktuale tradicionale që ofrohen nga UK në fushën e shkencave ekonomike, sociale, shëndetësore, vazhdojnë të kenë interes për maturantët. Ndërthurja e fushave të ndryshme për të ofruar diploma me natyrë dyfishe, aplikohet gjerësisht dhe në këtë drejtim, UK mund të shohë potenciale të reja që mund të ndërlihin programe në fusha të tjera që ofrohen nga institucioni.

V. KONKLUSIONE DHE PËRFUNDIME

Për herë të parë, Universiteti F.S.Noli, Korçë, zhvilloi një studim të mirëfilltë shkencor mbi institucionin, tregun e punës dhe rolin që ai luan në rajonin juglindor. Produkti më i rëndësishëm i këtij studimi është ky raport analitik dhe gjithëpërfshirës i cili përbën një bazë të mirë informacionesh e të dhënash për institucionin dhe mund dhe duhet t'i shërbejë institucionit në adresimin e politikave të veta të zhvillimit të programeve të studimit dhe orientimit të tyre drejt tregut të punës.

Një tjetër kontribut i këtij studimi është eksperiencia e fituar nga anëtarët e Grupit të punës në kryerjen e analizave dhe studimeve të tilla në arsimin e lartë. Ky rast studimor rezulton të jetë ndër të vetmit për një institucion të arsimit të lartë publik që merr në konsideratë një numër të madh informacionesh, të dhënash, faktorësh që ndikojnë etj. Kjo përvojë tashmë duhet të ndahet në Grupet e punës që do të ngrihen në kuadër të hapjes së programeve të studimit, ku studimi i tregut të punës për programet specifike, është domosdoshmëri. Metodologjia e ndjekur, informacioni dhe të dhënat e grumbulluara, janë një udhëzues i vlefshëm për t'u konsultuar në analizat në vijim që mund të kryejë institucioni ose njësitë kryesore dhe bazë të tij

Pavarësisht vështirësive në përfshirjen e sa më shumë aktorëve brenda dhe jashtë institucionit, studimi shërben si pikënisje për të përmirësuar disa tregues që lidhen me funksionimin e strukturave të brendshme të institucionit, me studentët e diplomuar, përditësimin e kontakteve të tyre, krijimin e databazës së tregut të punës në rajonin juglindor, përfshirjen e studentëve dhe profesionistëve në veprimtaritë e ndryshme që zhvillon institucioni pa përjashtuar kontributin e tyre në procesin e mësimdhënies dhe zhvillimit të praktikave profesionale.

Ky studim arriti të analizojë profilin e ekonomisë të qarkut të Korçës, drejtimet kryesore dhe potencialin e zhvillimit të saj. Njëkohësisht, ky potencial u analizua në funksion të punësimit dhe perspektivës së zhvillimit të programeve të UK dhe institucionit në tërësi.

Nëpërmjet të dhënave të mbledhura, mendimit të të diplomuarve dhe partnerëve të UK, studimi arriti të identifikojë disa nga pikat e forta dhe të dobëta që reflekton UK në këndvështrimin e tyre. Gjetjet e paraqitura sigurisht kanë subjektivizmin në raport me besueshmërinë e tyre, por nga kryqëzimi dhe analiza e informacioneve, rezulton se disa prej tyre duhet adresuar nga UK.

Orientimi i ulët i programeve drejt praktikës profesionale, mosmbështetja e studentëve për tregun e punës, janë dy nga gjetjet kryesore. Ndërkohë në studim u identifikuan raste ku personeli akademik është më pak kompetent në mësimdhënie dhe nuk përdor metoda inovative për ta bërë tërheqëse ato, nuk vlerëson në mënyrë korrekte apo nuk ruan etikën e komunikimit me studentët, pa përjashtuar edhe raste të abuzimit me studentët.

Këta tregues janë të rëndësishëm për t'u adresuar e analizuar nga ana e institucionit, pasi ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në reputacionin e tij tek studentët e ardhshëm.

Studimi evidentoi në mënyrë të qartë uljen e numrit të studentëve, analizuar në raport me uljen e popullsisë së qarkut dhe cilësinë e maturantëve në hyrje. Të dy faktorët ndikojnë negativisht në ecurinë afatgjatë të institucionit dhe në cilësinë e studentëve të diplomuar. Pavarësisht paqartësisë së politikave arsimore në nivel kombëtar, në vitin e fundit ka iniciativa për mbështetjen e programeve me interes kombëtar të cilat janë mundësi e mirë për institucionin të kontribuojë në këto programe.

Ne kemi sugjeruar disa iniciativa që duhet të ndërmerren në koordinim me institucionet e tjera në harmonizimin e programeve të studimit dhe kuotave duke marrë në konsideratë institucionet publike e private, institucionet politikëbërëse, MAS etj, në mënyrë që problematika uljes së popullsisë e për rrjedhojë e studentëve, të shihet në kontekstin e zhvillimit të rajonit për vetë rëndësinë që mbart UK në këtë rajon.

Së fundmi, studimi arriti të identifikojë disa nga drejtimet kryesore me potencial zhvillimi të rajonit e më gjerë të cilat mund të merren në konsideratë për zhvillimin e programeve të reja të studimit në partneritet me biznesin dhe tregun e punës.

Në një epokë të re ndryshime globale, zhvillimi i ekonomisë së vendit, integrimi evropian dhe iniciativa të tjera, ndikojnë pozitivisht në zhvillimin edhe të rajonit juglindor. Kjo krijon një perspektivë optimiste për universitetin si kontribuesi kryesor në zhvillimin social-ekonomik - shkencor të rajonit.

UNIVERSITETI I KORÇËS

Raport studimi mbi nevojat dhe mundësitë që ofron tregu i punës për
punësimin e të diplomuarve nga Universiteti F. S. Noli, Korçë

REKTORATI

Shtator 2022